# RAPORTI I VITIT 2015 MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kosova është demokraci parlamentare. Kushtetuta dhe ligjet parashohin parlamentin me përfaqësues të zgjedhur njëdhomësh (Kuvendin), i cili më pas e zgjedh kryetarin. Kryetari e zgjedh kryeministrin, të cilin duhet ta miratojë Kuvendi. Vendi i mbajti zgjedhjet e fundit parlamentare në qershor të vitit 2014, të cilat vëzhguesit ndërkombëtarë i konsideruan të lira dhe të drejta. Autoritetet civile mbajtën kontrollin efektiv mbi forcat e sigurisë. Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX), i cili monitoron policinë dhe sektorin e drejtësisë, vazhdoi t'i kryente disa funksione ekzekutive. Dialogu i Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga BE-ja, vazhdoi. Strukturat e drejtësisë në veri të Kosovës filluan të integrohen në strukturat nacionale pas marrëveshjes së 10 shkurtit për sektorin e drejtësisë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Më 27 tetor, kryeministri Mustafa nënshkroi Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim për Kosovën me Përfaqësuesen e Lartë të BE-së, Mogherini.

Njëra prej shqetësimeve më të rënda të të drejtave të njeriut gjatë vitit ishte pengimi, nganjëherë i dhunshëm, i Kuvendit nga ana e deputetëve opozitarë gjatë tetorit-dhjetorit, gjë që bllokoi debatin e lirë dhe miratimin e ligjeve. Korrupsioni endemik në sektorin qeveritar dhe në atë privat dhe mungesa e ndëshkimit për vepra të korrupsionit mbeti shqetësim i rëndësishëm i të drejtave të njeriut. Dhuna dhe diskriminimi shoqëror ndaj pakicave etnike, grave, personave me aftësi të kufizuara dhe anëtarëve të komunitetit të lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transgjinorëve dhe interseksualëve (LGBTI) përbënte fushën e tretë të shqetësimit të madh.

Shqetësimet tjera të të drejtave të njeriut përfshinin: keqtrajtimin e raportuar të të ndaluarve nga policia, kushtet fizike nën standarde në burgje; abuzimin me lëndë narkotike, korrupsionin dhe favoritizmin në burgje; paraburgimin e gjatë dhe joefikasitetin e gjyqësorit që përfundon në përmbyllje të rasteve pa gjykim; si dhe kërkesat e pazgjidhura për rikthim të pronës prej luftës së viteve 1998-1999. Ka pasur edhe frikësim të medieve nga zyrtarët publikë dhe elementët kriminelë, kufizim të lirisë së lëvizjes në urën *Austerlitz* mbi lumin Ibër, si dhe dhunë kundër të zhvendosurve që synonin të ktheheshin në shtëpitë e tyre. Kufizimet për lirinë fetare përfshinin mungesën e sistemit të regjistrimit dhe vandalizmin e përsëritshëm kundër pronës fetare, kufizimin e lirisë për lutje për pelegrinët ortodoksë serbë dhe përparimin e kufizuar në kthimin e të zhvendosurve në shtëpitë e tyre. Problemet tjera të të drejtave të njeriut përfshinin dhunën në familje dhe diskriminimin ndaj grave; përzgjedhjen e seksit mbi baza gjinore; abuzimin e fëmijëve; trafikimin e personave;

diskriminimin kundër pakicave, veçanërisht pakicës rome; mbështetjen joadekuate për personat me aftësi të kufizuar; kushtet e dobëta në objektet e shëndetit mendor; tensionet e herëpashershme etnike dhe puna e fëmijëve në sektorin joformal.

Qeveria ndërmori masa për t'i ndjekur penalisht dhe dënuar zyrtarët që kryen abuzime në shërbime të sigurisë apo gjetiu në Qeveri, ndonëse shumë veta mendonin që zyrtarët e lartë përfshiheshin në korrupsion pa u ndëshkuar.

**Seksioni 1. Respektimi i integritetit të personit, përfshirë lirinë nga:**

**a. Privimi arbitrar ose i paligjshëm i jetës**

Nuk ka pasur raportime që Qeveria apo agjentët e saj kryen vrasje arbitrare apo të paligjshme.

Prokurorët e EULEX-it dhe vendorë vazhduan ndjekjen penale të rasteve të krimeve të luftës që kanë ndodhur gjatë ose pas konfliktit të vitit 1998-1999, që solli pavarësinë e vendit. Deri në gusht, EULEX-i ishte duke i hetuar 174 raste të krimeve të luftës, kurse prej dhjetorit, prokurorët specialë i pranuan 37 raste të krimeve të luftës nga EULEX-i. Më 27 maj, një panel i gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën Themelore të Mitrovicës mori vendim për 15 të pandehur në rastet për krime të luftës, Drenica I dhe Drenica II. Në rastin Drenica I, gjykata dënoi ambasadorin e vendit në Shqipëri, Sylejman Selimi dhe kryetarin e komunës së Skenderajit, Sami Lushtaku për krime lufte kundër civilëve; Lushtaku u dënua edhe për vrasje. Gjykata i liroi pesë të pandehurit e tjerë. Në aktgjykimin në rastin Drenica II, gjykata i dënoi dhjetë të pandehurit për krime lufte kundër civilëve, kurse Selimi dhe tre të tjerë u shpallën fajtorë edhe për torturë dhe trajtim çnjerëzor. Gjykata e dënoi Lushtakun me 12 vjet burgim dhe Selimin me tetë vjet. Tre prej të dënuarve u dënuan me nga gjashtë vjet burgim. Gjashtë të tjerë, përfshirë edhe deputetë të Kuvendit të tanishëm dhe kryetarin e komunës së Gllogocit, u dënuan me nga tre vjet. Të gjithë të pandehurit që u dënuan me nga tri vjet burgim janë në liri në pritje të apelit. Dy deputetë më vonë hoqën dorë nga mandati në pajtim me ligjin.

Sipas medieve, Lushtaku, Selimi dhe një i dënuar tjetër përdorën arsyetime të rrejshme për të qëndruar kryesisht në dhoma private në Qendrën Mjekësore në Prishtinë dhe për t'i ikur burgimit në burgun e Dubravës. Policia e EULEX-it e arrestoi sërish Lushtakun më 22 shtator nën pretendimin se i ka shpërfillur kushtet sipas të cilave ka kërkuar trajtim në qendrën mjekësore.

Më 3 gusht, Kosova miratoi ndryshimet kushtetuese dhe legjislacionin për krijimin e Dhomave të Specializuara për t'i gjykuar të dyshuarit e hetuar nga

Task Forca për Hetime Speciale e BE-së. Task Forca për Hetime Speciale u krijua pas raportit të Këshillit të Evropës për krimet e pretenduara të kryera nga udhëheqës individualë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjatë dhe menjëherë pas luftës në Kosovë. Task Forca për Hetime Speciale kishte mandat për të hetuar dhe nëse ishte e arsyeshme, për të përgatitur raste për ndjekje penale për krimet e rënda të pretenduara në raportin e Këshillit të Evropës, përfshirë edhe për krime lufte dhe krim të organizuar. Legjislacioni për krijimin e Dhomave të Specializuara parashihte krijimin e një zyre të Prokurorisë së Specializuar brenda Dhomave të Specializuara me kompetencë për të ngritur aktakuza kundër të dyshuarve dhe parasheh që disa prej procedurave gjyqësore të mbahen në një vend tjetër evropian. Në fund të vitit, Kosova ishte duke negociuar me qeverinë holandeze rreth hollësive administrative për Dhomat.

Më 2 tetor, Ministria e Drejtësisë pezulloi dënimet e Sabit Gecit dhe Riza Aliajt për tre muaj për t'iu lejuar që të kërkojnë trajtim shëndetësor në Shqipëri. Geci dhe Aliaj ishin shpallur fajtorë në vitin 2011 për krime lufte të kryera në një qendër ndalimi në veri të Shqipërisë dhe ishin duke vuajtur dënimin prej 15, respektivisht 12 vjet burgim. EULEX-i apeloi kundër vendimit për pezullim, por më 27 tetor, Gjykata e Apelit e mbështeti vendimin për pezullim.

Më 6 tetor, Policia e EULEX-it arrestoi të dyshuarin për krime lufte, Xhemshit Krasniqi në Prizren. Kundër Krasniqit ishte ngritur aktakuza për një rast që përfshinte krime lufte në dy qendra ndalimi në veri të Shqipërisë në vitin 1999.

Më 2 dhjetor, një panel i përbërë me shumicë nga gjyqtarë të EULEX-it i Gjykatës së Apelit fillori rishikimin e apelit të vendimit për lirim të vitit 2013 kundër deputetit Fatmir Limaj dhe nëntë të tjerëve. Vendimi për lirim për akuza për krime lufte lidhej me abuzim të pretenduar në qendrën e ndalimit në Kleçkë afër Lipjanit në vitin 1999.

Më 8 dhjetor, gjykimi i gazetarit Milaim Zeka dhe Rrustem Rukollit, koordinatorit të mbrojtjes së kryetarit të komunës Lushtaku, vazhdoi për akuzat për shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe përpjekje për të ndikuar në një dëshmitar të mbrojtur për ta tërhequr dëshminë e tij.

Gjykimi i udhëhequr nga EULEX-i kundër Oliver Ivanoviqit, Dragolub Delibashiqit dhe tre të pandehurve të tjerë të arrestuar në vitin 2014 vazhdoi. Ata ishin akuzuar për krime lufte, vrasje të rëndë dhe shkelje të tjera kundër shqiptarëve të Kosovës në vitet 1999-2000.

Të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës u ankuan se prokurorët e EULEX-it nuk ndoqën penalisht asnjë rast. Ministria e Drejtësisë udhëhoqi një grup punues, ku përfshiheshin edhe EULEX-i dhe Zyra e Prokurorit Special, për t'iu

dhënë prioritet rasteve. Këshilli Gjyqësor i Kosovës miratoi një vendim për caktimin e dhjetë gjykatësve, të cilët do të përqendroheshin në rastet e dhunës seksuale. Ligji dhe buxheti parashihte mbështetje financiare për disa prej të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës, megjithatë komisioni nuk e ka filluar përzgjedhjen e përfituesve.

**b. Zhdukja**

Nuk pati raportime për zhdukje, rrëmbime apo kidnapime me motive politike gjatë këtij viti.

Deri në fund të vitit, sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), janë 1.670 persona të zhdukur gjatë konfliktit të viteve 1998-99 dhe dhunës politike që pasoi. Ndonëse KNKK-ja nuk i dallon personat e zhdukur sipas prejardhjes etnike për shkak të kufizimeve për konfidencialitet, vëzhguesit sugjeruan që përafërsish 70 për qind e tyre ishin shqiptarë të Kosovës dhe 30 për qind ishin serbë të Kosovës, romë të Kosovës, ashkalinjë të Kosovës, egjiptianë të Kosovës, boshnjakë të Kosovës dhe malazezë të Kosovës.

Delegacioni i Serbisë lejoi anëtarët e delegacionit të Kosovës t'i bashkëngjiteshin EULEX-it, Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, KNKK-së dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) gjatë zhvarrosjes në Kizhevak të Serbisë, ku forcat serbe supozoheshin të kishin varrosur mbetjet mortore të shqiptarëve të Kosovës të vrarë në Rezallë të Kosovës në vitin 1999. Gjatë takimit të mbajtur më 9 dhjetor të grupit punues për të zhdukurit, të udhëhequr nga KNKK-ja, delegacioni i Kosovës ia siguroi delegacionit të Serbisë kopjet e regjistrave të morgjeve të Prishtinës, të Gjakovës, Pejës dhe Gjilanit të viteve 1998-2000, që do të mund të ndihmonin në sqarimin e fatit të serbëve të zhdukur.

Përpjekjet për gjetjen e mbetjeve vazhduan me rezultate të kufizuara. Komisioni qeveritar për personat e zhdukur raportoi se EULEX-i dhe Departamenti i Mjekësisë Ligjore kreu 19 operacione në terren dhe zhvarrosje. Katër persona të zhdukur u identifikuan bazuar në riekzaminimin e rasteve të zgjidhura më herët, përfshirë edhe ritestimin e vendvarrimeve të kaluara. Më 1 gusht, Zyra e BE-së në Kosovë ia siguroi Komisionit qeveritar 400.000 euro (440.000 dollarë) për të testuar dhe përputhur ADN-në lidhur me personat e zhdukur prej periudhës së viteve 1998-2000. Fondet po ashtu kishin për synim që të përdoreshin për të nxjerrë një udhëzues për familjet e të zhdukurve dhe një kornizë ligjore për llogaritjen e personave të zhdukur, rishikimin e Raportit Vlerësues të Kosovës (që përshkruan statusin e përpjekjeve për lokalizimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të zhdukur), si dhe për përmirësimin e kapaciteteve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë.

## c. Torturimi dhe trajtimet apo ndëshkimet e tjera të egra, çnjerëzore apo poshtëruese

### Dënimi

Ligji i ndalon praktikat e tilla, por pati disa raportime që zyrtarët qeveritarë i përdorën ato.

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), një organ i pavarur brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka përgjegjësinë për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve për sjelljen e policisë. IPK-ja hetoi 40 akuza të përdorimit të tepërt të dhunës nga policia gjatë shpërndarjes së një demonstrate të datës 27 janar. Policia përdori gaz lotsjellës dhe top të ujit me shtypje pasi u sulmua nga protestuesit që hidhnin gurë dhe koktej molotovi. IPK-ja i përfundoi hetimet dhe, në konsultime me zyrën e prokurorisë, dorëzoi katër raste në Departamentin e Policisë për Standarde Profesionale për veprim disiplinor. Raporti i IPK-së i shënoi nëntë raste që përmbanin elemente të veprës penale për keqtrajtim dhe shkaktim të lëndimeve trupore gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare. Deri më 7 dhjetor, zyra e prokurorit po i shqyrtonte këto nëntë raste.

Më 18 nëntor, një panel gjyqtarësh me shumicë nga EULEX-i në Gjykatën Themelore në Prishtinë i shpalli gjashtë anëtarë të Njësitit Rajonal për Mbështetje Operacionale, që është i ngjashëm me ekipet SWAT, fajtorë për keqtrajtimin e civilëve serbë të Kosovës gjatë kohës sa ishin në detyrë zyrtare në vitin 2013. Njëri prej tyre u dënua me 18 muaj, kurse të tjerët u dënuan me kusht prej një deri në dy vjet. Të gjithë të dënuarit u ndaluan së ushtruari çfarëdo funksioni publik për dy vjet. Gjykata i liroi pesë zyrtarë të policisë.

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut pohuan se policia përdori forcë të tepërt gjatë arrestimit të deputetit Albin Kurti dhe 97 anëtarëve të tjerë të partisë Vetëvendosje në selinë qendrore të partisë më 28 nëntor. Autoritetet e arrestuan Kurtin nën akuzën për përdorim të dhunës në Kuvend, sipas pamjeve televizive të seancës plenare; të tjerët u ndaluan për shkak të pengimit të dhunshëm të arrestimit të Kurtit. Më 4 dhjetor, Institucioni i pavarur i Avokatit të Popullit (IAP) kërkoi nga Zyra e Prokurorisë Themelore në Prishtinë t'i hetojë pretendimet që policia përdori forcë të tepruar. IPK-ja nuk mori asnjë ankesë publike lidhur me incidentin, por më 21 dhjetor njoftoi se po hetonte 12 raste. Komisioni për rishikimin e përdorimit të forcës dhe Departamenti për Standarde Profesionale e Policisë po ashtu nisën një rishikim. EULEX-i shprehu pikëpamjen se policia kishte përdorur forcë proporcionale në operacion, duke mbrojtur rendin publik dhe, kur ishte e nevojshme, veten.

Vëzhguesit vendorë, përfshirë përfaqësuesit e IAP-së dhe të QKRMT-së, të cilët bënin vizita periodike në burgje, treguan se keqtrajtimi i të burgosurve dhe i të ndaluarve vazhdonte të përbënte shqetësim.

**Kushtet në burgje dhe qendra të ndalimit**

Kushtet në burgje dhe qendra të ndalimit në përgjithësi i plotësonin standardet ndërkombëtare, por vazhdojnë problemet e mëdha me hapësirat e mangëta fizike, dhunën ndërmjet të burgosurve, korrupsionin dhe kujdesin mjekësor nën standard.

Kushtet fizike: Sipas QKRMT-së, kushtet fizike dhe të jetesës mbesin nën standard në disa objekte në burgun e Dubravës, që mban numrin më të madh të burgosurve. Mangësitë në Dubravë përfshinin ndriçimin dhe ventilimin e dobët në disa qeli, kuzhinat dhe tualetet e vjetruara, mungesën e ujit të ngrohtë dhe shtrojat joadekuate apo mungesa e tyre.

QKRMT-ja mori 10 ankesa nga të burgosurit për abuzim verbal dhe në disa raste fizik nga stafi korrektues në burgun e Dubravës, e në dy raste në burgun e sigurisë së lartë.

Për shkak të korrupsionit dhe ndërhyrjes politike, autoritetet nganjëherë nuk kishin kontroll mbi objektet ose të burgosurit. Sipas QKRMT-së, të burgosurit janë ankuar se zyrtarët në burgun e Dubravës dhe atë të Smerkovnicës paligjshëm dhanë lejedalje dhe kohë shtesë në oborr për shkak të nepotizmit ose ryshfetit. QKRMT-ja raportoi se telefonat celularë dhe lëndët narkotike të paligjshme rregullisht hynin me kontrabandë në objektet korrektuese; vlerësohej se më shumë se 30 për qind të të dënuarve janë të varur nga droga. Më 28 gusht, drejtori i Qendrës së paraburgimit në Prizren, Ilir Gutaj, dha dorëheqje, kurse shtatë zyrtarë të tjerë të shërbimit korrektues u pezulluan, pas pretendimeve për korrupsion dhe për ndihmë në ikjen e një të burgosuri të akuzuar për vrasje. Ministria e Drejtësisë bashkë me EULEX-in themeloi një komision hetimor. Më 2 tetor, drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Emrush Thaçi dha dorëheqje pas raporteve të medieve për trajtim preferencial të të burgosurve me lidhje të forta dhe për shkak të ikjes nga burgu i Prizrenit.

QKRMT-ja dokumentoi vonesa dhe gabime në ofrimin e trajtimit mjekësor për të burgosur dhe mungesën e trajtimit të specializuar, si për të varurit nga droga. Në shumë raste, kushtet i detyronin të burgosurit t'i blinin barnat e nevojshme përmes burimeve private. QKRMT-ja vërejti mangësi në sistemin e kujdesit shëndetësor në burgun e Dubravës dhe raportoi për numrin e pamjaftueshëm të profesionistëve të shëndetit mendor.

QKRMT-ja vërejti se objektet dhe trajtimi i të burgosurve me aftësi të kufizuara mbeti nën standard. Shërbimi Korrektues i Kosovës i mbajti të dënuarit me aftësi të kufizuara ndaras nga popullata e përgjithshme e burgut. Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës, që u hap në qershor 2014, ofroi trajtim dhe strehim të kufizuar për të ndaluarit me aftësi të kufizuara mendore. Mbrojtësit e personave me aftësi të kufizuara kritikuan qeverinë për shkak se rregullisht i mbajti të paraburgosurit të diagnostifikuar me aftësi të kufizuara mendore bashkë me të paraburgosurit e tjerë, edhe pse Shërbimi Korrektues i Kosovës i mbante të paraburgosurit ndaras nga popullata e përgjithshme e burgut. Nuk pati dispozita ligjore apo udhëzime administrative për trajtimin e të burgosurve me nevoja speciale.

Administrata: Zyrtarët mbanin shënime për të burgosurit, por administratorët e SHKK-së pohonin se ndarja e përgjegjësive për të paraburgosur dhe të dënuar shkaktonte probleme. P.sh., autoritetet e burgut nuk mund të intervenonin kur të paraburgosurit me lidhje të mira i përdornin lidhjet në Ministrinë e Drejtësisë për t'u transferuar në objekte më komode, si në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë, madje edhe kur burgu ua ofronte shërbimet përkatëse mjekësore.

Ekziston sistemi për paraqitjen e ankesave te autoritetet gjyqësore, por të burgosurit u thanë përfaqësuesve të QKRMT-së se nuk i besonin atij sistemi. Monitoruesit e burgjeve raportuan se Shërbimi Korrektues në mënyrë sistematike i transferonte të burgosurit prej një objekti në tjetrin pa e njoftuar paraprakisht të burgosurin apo pa ia ofruar mundësinë për të paraqitur ankesë kundër një vendimi të tillë.

Edhe të burgosurit edhe punëtorët socialë e përshkruanin Panelin për lirim me kusht si "të dobët" për shkak të dështimit për t'i shqyrtuar me kohë kërkesat për lirim të hershëm dhe për shkak të mungesës së qartësisë në arsyetimin e mohimeve të kërkesave për lirim.

Monitorimi i pavarur: Qeveria u lejoi vizita vëzhguesve të pavarur të të drejtave të njeriut, por IAP-i ishte institucioni i vetëm që kishte qasje të vazhdueshme dhe të papenguar në objektet korrektuese. QKRMT-ja dhe Këshilli për Mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut (KMDLNJ) duhej t'i paraqitnin 24 orë më herët aktivitetet e planifikuara monitoruese. IAP-i, QKRMT-ja dhe KMDLNJ-a vepruan si Mekanizëm Kombëtar Parandalues, një organ bashkërenditës i përbashkët për monitorimin e procedurave të arrestimit dhe pretendimeve të besueshme të kushteve jonjerëzore në burg.

Përmirësimet: Sipas QKRMT-së, Shërbimi Korrektues i Kosovës riparoi qelitë në disa institucione korrektuese, përfshirë edhe në dy njësite të burgut të Dubravës. Autoritetet filluan t'i dërgonin të burgosurit në Burgun e ri të sigurisë

së lartë, i cili u hap në vitin 2014 në Gërdoc afër Podujevës. Deri në dhjetor, në këtë objekt ishin 125 të burgosur (104 të burgosur dhe 21 të ndaluar në pritje të gjykimit), që është më pak se gjysma e të burgosurve që ishte paraparë t'i mbante.

Më 19 qershor, Ministria e Punëve të Brendshme hapi qendrën e re të ndalimit për të huaj në Vranidoll. Objektet e saj në përgjithësi i plotësuan standardet ndërkombëtare.

**d. Arrestimi ose ndalimi arbitrar**

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe Qeveria, EULEX-i dhe Forca e Kosovës (KFOR), forca paqeruajtëse ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO, në përgjithësi i respektuan këto ndalesa.

**Roli i policisë dhe i aparatit të sigurisë**

Forcat vendëse të sigurisë përfshijnë Policinë e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK). Ligji parashikon që policia të funksionojë nën autoritetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Policia mban sigurinë e brendshme, e ndihmuar nga EULEX-i, si reagues i dytë dhe KFOR-i, si reagues i tretë. Policia kufitare, që funksionon brenda Policisë së Kosovës, është përgjegjëse për çështjet e zbatimit të ligjit lidhur me menaxhimin e kufirit.

FSK-ja është forcë civile e reagimit, me armatim të lehtë që ofron reagim ndaj fatkeqësive dhe ndihmë humanitare, çminim, kërkim dhe shpëtim dhe kontroll dhe pastrim të materieve të rrezikshme. Ajo i përgjigjet Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës.

EULEX-i, me mandatin për të monitoruar, mentoruar dhe këshilluar institucionet vendore të drejtësisë dhe të zbatimit të ligjit, e që po ashtu ka disa përgjegjësi operacionale, shërbeu, bashkë me forcën policore, si reagues i dytë, përfshirë edhe gjatë bastisjeve dhe aksioneve që kërkonin kontroll të turmës dhe trazirave. EULEX-i ka mandat të kufizuar dhe të përkufizuar për operacionet policore, me kompetenca të kufizuara ekzekutive në rastet e krimit të organizuar, korrupsionit të nivelit të lartë, krimeve të luftës, shpëlarjes së parave, financimit të terrorizmit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar policor. Po ashtu, përfshihet edhe në operacionet e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe trajnim të policisë në mbrojtjen e dëshmitarëve. Roli ekzekutiv i EULEX-it vazhdoi të zvogëlohej gradualisht, siç parashihet në letërkëmbimin ndërmjet qeverisë dhe BE-së të prillit të vitit 2014. Personeli i EULEX-it dhe KFOR-it në përgjithësi vepronte pa u ndëshkuar nga sistemi ligjor i vendit, por iu nënshtrohej masave

disiplinore të misioneve dhe vendeve të veta përkatëse. Nuk pati raportime për abuzim nga ana e EULEX-it apo KFOR-it.

Qeveria hetoi abuzimin dhe korrupsionin, ndonëse mekanizmat për ta bërë një gjë të tillë nuk ishin njësoj efikas në tërë vendin. Shumica e forcave vendëse të sigurisë në Kosovën veriore kaluan nën kontrollin e qeverisë, si pjesë e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, të ndërmjetësuar nga BE-ja.

**Procedurat e arrestimit dhe trajtimi i të ndaluarve**

Ligji parashikon që policia mund të arrestojë persona vetëm në bazë të urdhrave të bazuar në prova dhe të lëshuar nga gjykatësi ose prokurori, përveç kur has në një krim që është në zhvillim e sipër. Sipas ligjit, prokurorët duhet t'ia lëshojnë të arrestuarit një deklaratë me shkrim duke i përshkruar shkeljet e dyshuara dhe bazën ligjore për akuza ose ta lirojnë atë. Autoritet duhet t'i sjellin të arrestuarit para gjyqtarit brenda 48 orësh ose t'i lirojnë. Autoritet duhet t'u sigurojnë të ndaluarve qasje në avokatin të cilin e zgjedhin apo t'ua sigurojnë një avokat. Ekziston sistemi i dorëzanisë. Të dyshuarit kanë të drejtë të refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve gjatë të gjitha fazave të hetimit, përveç pyetjeve për identitetin e tyre. Të dyshuarit kanë të drejtë për ndihmë falas të përkthyesit dhe për trajtim mjekësor dhe psikiatrik. Policia nuk mund t'i mbajë të dyshuarit pa mundësi komunikimi.

Pas një aktvendimi fillestar, gjykata mund t'i mbajë individët në paraburgim deri në 30 ditë nga data e arrestimit dhe mund ta vazhdojë paraburgimin e tyre deri në një vit pa ngritur aktakuzë. Pas ngritjes së aktakuzës dhe deri në përfundim të procedurës gjyqësore, vetëm gjykatësi i rastit apo trupi gjykues mund ta urdhërojë apo ndërpresë paraburgimin. Ligji lejon që gjykatësi të urdhërojë arrestin shtëpiak, konfiskimin e dokumenteve të udhëtimit dhe përdorimin e gjerë të dorëzanisë si alternativa ndaj paraburgimit. Të pandehurit gjithashtu mund të ankohen kundër paraburgimit të tyre dhe të ndaluarit mund të paraqesin ankesa për ta kontestuar ligjshmërinë ose kushtet e paraburgimit të tyre. Të pandehurit e ndaluar në mënyrë të paligjshme gjithashtu mund të paraqesin padi për dëmshpërblim.

Shumica e arrestimeve kryheshin në përgjithësi nga policia, në disa raste nga policë të maskuar apo sekretë, duke përdorur urdhër-arrestin. Nuk pati raportime të konfirmuara që policia abuzoi rregullin 48-orësh dhe prokurorët në përgjithësi ose u ofronin personave të arrestuar dokumente në të cilat cekeshin arsyet për ndalimin e tyre ose i lironin. Zyrtarët në përgjithësi e respektuan kriterin për vendosje të shpejtë të rasteve, por QKRMT-ja raportoi se të ndaluarit nganjëherë përballeshin me vonesa kur avokatët nuk ishin në dispozicion deri në mëngjes pas ndalimit të personit. Gjykatat rrallëherë e

përdorën dorëzaninë, por shpesh i lironin të ndaluarit pa dorëzani në pritje të gjykimit.

OJQ-të raportuan se autoritetet nuk i lejonin personat e ndaluar të kontaktonin me avokatë me rastin e arrestimit, në disa raste, zyrtarët u mundësuan të ndaluarve këshillimin me avokat vetëm kur policët e hetuesisë fillonin marrjen formale në pyetje. Në disa raste, të ndaluarit kishin mundësi të kenë qasje në avokat vetëm pas marrjes formale në pyetje. Disa të ndaluar ankoheshin që kontakti i tyre i parë me avokatin ndodhte vetëm pas paraqitjes së tyre të parë në gjykatë edhe pse kishin kërkuar avokat menjëherë pas arrestimit të tyre.

Paraburgimi: Ndalimet e gjata, para dhe gjatë procedurës gjyqësore, mbetën problem. Ligji lejon që gjykatësi ta shqiptojë masën e paraburgimit nëse ekziston dyshimi i bazuar se personi që ka kryer vepër penale ka të ngjarë t'i shkatërrojë, fshehë apo falsifikojë provat; të ndikojë në dëshmitarë; të ikë; ta përsërisë veprën penale apo të kryejë ndonjë vepër tjetër penale; apo të mos paraqitet në procedura gjyqësore. Gjykatësit zakonisht e përdornin paraburgimin pa kërkuar justifikim të mbështetur në prova. Paraburgimi i gjatë pjesërisht ndodhi për shkak të joefikasitetit dhe korrupsionit në gjyqësor.

**e. Mohimi i gjykimit të drejtë publik**

Kushtetuta parashikon gjyqësor të pavarur, por gjyqësori nuk ofronte gjithmonë proces të drejtë. Sipas Komisionit Evropian, ndarja e drejtësisë ishte e ngadalshme dhe dhënia e llogarisë nga ana e zyrtarëve të gjyqësorit ishte e pamjaftueshme. Strukturat e gjyqësorit prireshin të kishin ndërhyrje politike, me emërime të kontestuara dhe mandate të paqarta. Sipas Këshillit Gjyqësor të Kosovës, deri në janar, ishin 395.274 raste civile e penale që pritnin të gjykoheshin. Mbi 118.000 masa të shqiptuara me vendime gjyqësore pritnin të ekzekutoheshin dhe më shumë se 186.365 padi për kundërvajtje pritnin të gjykoheshin.

Në vend ekziston një mekanizëm efikas për procedura disiplinore kundër gjykatësve dhe prokurorëve. Autoritetet në përgjithësi i respektuan urdhrat e gjykatave.

Prokurorët dhe gjyqtarët e EULEX-it vazhduan të funksiononin si anëtarë të ngjitur në sistemin gjyqësor të vendit. Shefja e Prokurorisë Speciale, me juridiksion mbi krimet e rënda, përfshirë trafikimin e personave, krimet kundër njerëzimit, shpëlarjen e parave, krimet e luftës dhe terrorizmin, kishte një prokuror të EULEX-it si zëvendës të vetin. Në përputhje me letërkëmbimin mes qeverisë dhe BE-së, që ia vazhdoi mandatin EULEX-it, prokurorët e EULEX-it mund të vazhdojnë të veprojnë në mënyrë të pavarur apo bashkë me prokurorët

vendorë në pajtim me ligjin në fuqi. Siç parashihet në letërkëmbim, EULEX-i vazhdoi t'i merrte disa raste të reja dhe të procedonte disa raste në vazhdim e sipër.

Më 14 prill, eksperti i pavarur Jean-Paul Jacque publikoi raportin lidhur me pohimet për korrupsion brenda EULEX-it t gjykatësit vendorë vazhduan të merrnin përgjegjësi nga EULEX-i, të bëra nga një ish-prokurore e EULEX-it. Raporti e shfajësoi misionin për korrupsion, por kritikoi mënyrën se si misioni i kishte shqyrtuar pohimet dhe procedurat e brendshme.

Si pjesë e zbatimit të vazhdueshëm të dialogut me Serbinë, shumica e rasteve civile dhe penale në veri të vendit nuk ishin proceduar për shkak se marrëveshja me Serbinë për çështje të drejtësisë e muajit shkurt ende nuk po zbatohej.

**Procedurat e gjykimit**

Ligji parashikon gjykim të drejtë e të paanshëm dhe gjyqësori në përgjithësi e respektoi ligjin. Gjykimet janë publike dhe të pandehurit gëzojnë prezumimin e pafajësisë, të drejtën për t'u informuar me kohë dhe hollësisht për akuzat kundër tyre, të jenë të pranishëm në gjykimet e veta, të heshtin, të mos detyrohen të dëshmojnë apo ta pranojnë fajësinë, të përballen me dëshmitarët kundërshtarë, t'i shohin provat dhe të kenë përfaqësim ligjor. Të pandehurit kanë të drejtë të ankohen. Vendi nuk mban gjykime me juri.

Sipas Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, një agjenci e pavarur qeveritare me mandat për të ofruar ndihmë juridike falas personave me të ardhura të ulëta, nuk ka funksionuar siç ishte paraparë, duke ofruar vetëm këshilla ligjore, pa i përfaqësuar rastet në gjykatë. Një sektor i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit iu ndihmoi viktimave të krimit për të pasur qasje në drejtësi. Ky sektor u ofronte ndihmë juridike falas viktimave të të gjitha krimeve me fokus të veçantë në viktimat e dhunës në familje, trafikimit të personave, abuzimit të fëmijës dhe dhunimit.

Ministria e Drejtësisë drejtonte sektorin për integrim gjyqësor, me dy zyra ndërlidhëse me gjykatat, për t'u ndihmuar komuniteteve pakicë në zonat e Kosovës me shumicë serbe duke i shoqëruar në gjykata, duke paraqitur dokumente në gjykata në emër të tyre dhe duke u siguruar refugjatëve dhe personave të zhvendosur informata dhe ndihmë juridike.

**Të burgosurit dhe të arrestuarit politikë**

Nuk pati raportime për të burgosur apo të arrestuar politikë.

## Procedurat dhe mjetet juridike civile

Pati mjete juridike civile për shkelje të të drejtave të njeriut, por viktimat nuk mund ta shfrytëzonin këtë të drejtë për shkak të procedurave të ndërlikuara burokratike dhe numrit të madh të lëndëve të pazgjidhura gjyqësore. Individët mund të ankohen në gjykata për të kërkuar dëmshpërblim për shkelje të të drejtave të njeriut, apo ndalim të shkeljes së të drejtave të njeriut. Më 28 maj, Kuvendi miratoi Ligjin për dëmshpërblimin e viktimave të krimit, duke krijuar një program për dëmshpërblimin e viktimave të krimit për viktimat e krimeve të dhunshme dhe vartësit e tyre. Ministria e Drejtësisë caktoi një grup punues për hartimin e udhëzimeve administrative për zbatimin e ligjit. Individët mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e të drejtave të tyre për proces të drejtë. Kushtetuta parasheh që vendi duhet t'i respektojë obligimet e cekura në shumë konventa ndërkombëtare. Individët mund t'i parashtrojnë shkeljet e pretenduara të këtyre konventave, si dhe shkeljet e proceseve të duhura të parapara me ligjin e vendit, në Gjykatën Kushtetuese.

## Rikthimi i pronës

Qeveria vazhdoi të shënonte përparim në zgjidhjen e rasteve për rikthimin e pronës. Një përzierje konfuze e ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe praktikave gjyqësore, si dhe rizënia ilegale e pronave dhe kërkesat e shumta për të njëjtën pronë vazhduan ta pengojnë zgjidhjen e rasteve të të drejtave pronësore.

Deri në dhjetor, Komisioni për kërkesa pronësore i Kosovës kishte nxjerrë vendime për 41.849 kërkesa prej gjithsej 42.749 kërkesave të regjistruara dhe autoritetet njoftuan shumicën e parashtruesve për rezultatet. Komisioni raportoi se autoritetet e Agjencisë Kosovare të Pronave (AKP) i kishin zbatuar 35.167 vendime të saj. Një numër i tyre ishin në apel në Gjykatën Supreme për masa të mëtejme.

AKP-ja, një organ thuaja-ligjor, kishte vështirësi në zbatimin e vendimeve të veta gjatë dëbimit të zaptuesve të paligjshëm. AKP-ja po ashtu kishte mungesë të fondeve për ta paguar shumën prej 3.2 milionë eurosh (3.5 milionë dollarë) në emër të dëmshpërblimit për 143 rastet e vendosura në favor të parashtruesve të kërkesave që i kishin humbur pronat e tyre në fillim të viteve 1990 për shkak të praktikave diskriminuese banesore që zbatoheshin aso kohe. Agjencia kishte mungesë të fondeve edhe për t'i larguar strukturat e paligjshme të ndërtuara në tokë pasi parashtruesve të kërkesës u ishte konfirmuar e drejta e tyre për tokën.

Numri i pazgjidhur i kërkesave pronësore në gjykata komunale mbeti i lartë. Deri në dhjetor, janë rreth 9.200 kërkesa të pazgjidhura, shumica përfshinin

kërkesa financiare të serbëve të Kosovës për pronën e pabanueshme të dëmtuar nga lufta. Vendit i mungonte një sistem efektiv për t'ua mundësuar serbëve të zhvendosur nga Kosova për të paraqitur kërkesa pronësore dhe kërkesa të tjera nga jashtë vendit.

**f. Ndërhyrja arbitrare në intimitet, familje, shtëpi apo korrespondencë**

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë veprime të tilla dhe Qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i në përgjithësi i respektuan këto ndalesa.

**Seksioni 2. Respektimi i lirive civile, përfshirë:**

**a. Lirinë e fjalës dhe të shtypit**

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e fjalës dhe të shtypit. Ndonëse Qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta, pati raportime që zyrtarë publikë, politikanë, biznese dhe grupe radikale fetare përpiqeshin t'i kërcënonin përfaqësuesit e medieve. Mediet gjithashtu hasën në vështirësi me rastin e marrjes së informatave nga Qeveria dhe institucionet publike siç parashihet me ligj.

Kushtetuta parashikon një Komision të Pavarur për Media (KPM), një organ përgjegjësitë parësore të të cilit janë t'i rregullojë frekuencat e transmetimit, t'u lëshojë leje transmetuesve publikë e privatë dhe të përcaktojë e zbatojë politika transmetuese. KPM-ja emëroi dy anëtarë nga radhët e pakicave në prill, duke i plotësuar kështu të gjitha ulëset në bord.

Liria e shtypit: Mediet e pavarura ishin aktive dhe shprehën një gamë të gjerë të pikëpamjeve, në përgjithësi pa kufizim, edhe pse pati raportime për presion verbal nga zyrtarët qeveritarë, disa parti politike, biznese të lidhura me Qeverinë, grupet fetare dhe disa individë të pakënaqur ndaj pronarëve të medieve, redaktorëve të caktuar dhe reporterëve për të mos publikuar storie apo materiale të caktuara.

Rritja e vështirësive financiare të mediumeve e vuri në rrezik pavarësinë redaksionale të medieve të shkruara dhe elektronike. Përderisa disa mediume financiarisht të pavarura zhvilluan politika redaksionale të pavarura nga interesat politike apo të biznesit, mediumet me më pak resurse nganjëherë pranuan ndihmë financiare nga një sërë burimesh në shkëmbim për raportim pozitiv apo për mospublikim të storieve negative që do të mund t'i dëmtonin interesat e financuesve.

Mediet transmetuese, veçanërisht kanalet televizive, kishin më tepër qasje në burime substanciale të të ardhurave sesa mediet e shkruara. Kuvendi kontrollon buxhetin e transmetuesit publik, RTK-së dhe degëve të tij. Publiku i perceptonte mediet transmetuese si më të pavarura, por stacionet e vogla raportonin se vazhdimisht përballeshin me rrezikun e mbylljes dhe gjithnjë e më shumë vareshin nga burimet më të pakta të jashtme të financimit. Mediet e internetit, që operonin pa rregullore, ushtronin trysni të mëtejmë mbi mediet transmetuese duke ribotuar artikuj nga shtypi ose burime të tjera të internetit, shumicën e herës pa cekur burimin kryesor.

Dhuna dhe ngacmimi: Deri më 8 dhjetor, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe mediet raportuan për 27 raste në të cilat zyrtarë qeveritarë, grupe të interesit afarist ose grupet radikale fetare abuzuan me lirinë e shtypit, përfshirë sulmet fizike dhe kërcënimet verbale ndaj gazetarëve, presionin ndaj medieve për të mos publikuar materiale të caktuara, dhe pengimin e punës së gazetarëve.

P.sh., gjatë një proteste kundër qeverisë në Prishtinë më 27 janar, disa protestues sulmuan fizikisht një gazetar serb-folës dhe kameramanin e RTK2 dhe të transmetuesit publik të Republikës së Serbisë, Radiotelevizioni i Serbisë. Mediet nuk raportuan për ndonjë arrestim apo aktakuzë për këtë incident.

Censurimi ose kufizimi i përmbajtjes: Ndonëse nuk kishte raporte për censurim të drejtpërdrejtë të medieve të shkruara apo elektronike, gazetarët pohonin që presioni nga politikanët dhe krimi i organizuar shpesh rezultonte në vetëcensurim. Disa gazetarë përmbaheshin nga raportimi hetues kritik për shkak të frikës për sigurinë e tyre personale apo vendin e tyre të punës. Gazetarëve nganjëherë u ofroheshin përfitime financiare në shkëmbim për raportim pozitiv apo heqje dorë nga ndonjë hetim. Sipas AGK-së, zyrtarët qeveritarë, si dhe disa kriminelë të dyshuar, gojarisht i kërcënonin disa gazetarë për raportimin që konsiderohej negativ. Sipas disa redaktorëve, agjencitë qeveritare dhe korporatat i tërhiqnin reklamat nga gazetat që publikonin material kritik për to.

Sipas AGK-së, shumë gazetarë ankoheshin se pronarët dhe drejtuesit e medieve i parandalonin prej publikimit ose transmetimit të storieve që kritikonin qeverinë, partitë politike ose zyrtarët e caktuar për shkak të parapëlqimeve të pronarëve për, ose për shkak të lidhjeve me personat e cekur. Në disa raste, thuhet se pronarët kishin kërcënuar t'i pushonin nga puna gazetarët nëse nxirrnin storie që kritikonin qeverinë dhe grupet e caktuara të interesit të lidhura me politikën. Disa gazetarë ankoheshin se pronarët i ndalonin ata që të prodhonin storie për korrupsionin e nivelit të lartë në qeveri.

**Liria e internetit**

Qeveria nuk e kufizoi apo ndërpreu qasjen në internet apo censuroi përmbajtjen në internet, dhe nuk pati raportime të besueshme që Qeveria i vëzhgonte e-mailat apo bisedat në internet pa autoritet përkatës ligjor.

Në shtator, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare raportoi se 65 për qind e të gjitha amvisërive kishin lidhje interneti, ndërsa ueb-faqja Internet World Stats raportoi se 76.6 për qind e vendit e përdorte internetin në mesin e vitit 2014.

**Liria akademike dhe ngjarjet kulturore**

Qeveria nuk e kufizonte lirinë akademike apo ngjarjet kulturore.

**b. Liria e tubimit paqësor dhe asociimit**

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e tubimit dhe asociimit, dhe Qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i në përgjithësi i respektuan këto të drejta. Ligji për tubime publike kërkon që organizatorët ta njoftojnë policinë për protesta 72 orë para mbajtjes së tyre. Policia duhet t'i njoftojë organizatorët brenda 48 orëve nëse kërkesa e tyre është pranuar, përndryshe kërkesa konsiderohet e pranuar.

**c. Liria e fesë**

Shih *Raportin ndërkombëtar mbi lirinë e fesë* të Departamentit të Shtetit në: www.state.gov/religiousfreedomreport/.

**d. Liria e lëvizjes, personat e zhvendosur brenda vendit, mbrojtja e refugjatëve dhe personat pa shtetësi**

Ligji parashikon lirinë e lëvizjes brenda vendit, udhëtimin jashtë vendit, emigrimin dhe riatdhesimin dhe Qeveria e EULEX-i në përgjithësi i respektuan këto të drejta. Megjithatë, tensionet ndëretnike, barrikadat e vendosura nga ekstremistët dhe brengat e vërteta e të perceptuara të sigurisë e kufizonin lirinë e lëvizjes. Brengat e sigurisë gjithashtu penguan një numër të serbëve të zhvendosur të Kosovës që kërkonin të ktheheshin.

Qeveria bashkëpunoi me Zyrën e Komisariatit të Lartë të OKB-së për Refugjatë (UNHCR) dhe organizata të tjera humanitare për t'u ofruar mbrojtje dhe ndihmë personave të zhvendosur brenda vendit, refugjatëve, refugjatëve që ktheheshin, azilkërkuesve, personave në rrezik për pa shtetësi dhe komuniteteve pakicë të cenuara.

Lëvizja brenda vendit: Liria e lëvizjes në urën *Austerlitz* mbi lumin Ibër që lidh Mitrovicën e Jugut dhe atë të Veriut mbetet e penguar. Më 25 gusht, kryeministri arriti një marrëveshje me kryeministrin serb në Bruksel për të mundësuar lirinë e lëvizjes jo më vonë se në qershor të vitit 2016. Në të paktën tri raste, protestuesit shqiptarë të Kosovës ndaluan ose u përpoqën t'i ndalonin serbët e Kosovës për të marrë pjesë në shërbesa fetare në kisha, të cilat gjenden në zonat e banuara me shqiptarë të Kosovës. Në një rast, policia përdori gaz lotsjellës për të shpërndarë protestuesit dhe arrestoi një person.

**Personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV)**

Deri në tetor, UNHCR-ja vlerësoi se 16.893 persona ishin të zhvendosur në Kosovë dhe nëpër rajon si pasojë e luftës së vitit 1998-99 dhe trazirave të vitit 2004. Një numër domethënës i romëve të Kosovës, ashkalinjve të Kosovës dhe egjiptianëve të Kosovës mbesin të paregjistruar dhe të panumëruar nga autoritetet, përfshirë edhe nga Qendra për monitorim të të zhvendosurve brenda vendit. Shumë prej tyre jetonin në vendbanime joformale, të cilave iu mungonte rryma dhe shërbimet tjera themelore.

Sipas UNHCR-së, pothuajse 105.000 persona nga Kosova ishin zhvendosur në vendet e tjera të rajonit. Gjithsej 9.417 persona të zhvendosur (2.346 familje), kryesisht serbë të Kosovës, ia kishin shprehur UNHCR-së interesimin e tyre për tu kthyer vullnetarisht në Kosovë. Sipas Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, deri më 21 dhjetor ishin kthyer 704 persona.

Procesi i kthimit në mënyrë kronike lëngon nga incidentet e sigurisë dhe nga ngurrimi i komunitetit pranues për t'i pranuar pakicat që ktheheshin, veçanërisht në Gjakovë, Istog, Klinë, Mamushë dhe në Mitrovicën e veriut. Mungesa e sigurisë dhe lënia mënjanë e të kthyerve shpesh shpinte në zhvendosje të dytë. UNHCR-ja raportoi se vonesat e dukshme në sigurimin e ndihmës për riintegrim për të kthyerit vullnetarisht kontribuoi në zhvendosje të dytë ose migrim ilegal gjatë pjesës së parë të vitit.

Diskriminimi nga komunat dhe sulmet kundër romëve të Kosovës, ashkalinjve të Kosovës dhe egjiptianëve të Kosovës shkurajoi kthimin e tyre. Më 10 gusht, iu vu flaka materialit ndërtimor që komuna e Pejës e kishte blerë për një familje të kthyer egjiptiane të Kosovës.

Ministria për Komunitete dhe Kthime, me mbështetjen financiare të BE-së, i ndihmoi 10 familje me gjithsej 58 persona të zhvendosur të ktheheshin në vend, duke përfshirë ndihmë për të blerë bagëti, pajisje për ferma dhe mobilie dhe iu ofroi ndihmë për nxjerrjen e dokumenteve ligjore dhe të kredive për të filluar

ndërmarrje të vogla. Buxheti i Ministrisë për ndihmë për të kthyerit ishte 8,3 milionë euro (9,13 milionë dollarë) për këtë vit.

## Mbrojtja e refugjatëve

Qasja për azil: Ligji parashikon dhënien e statusit të azilantit apo refugjatit. Qeveria ka një sistem për t'u ofruar mbrojtje refugjatëve, por sipas UNHCR-së, asaj i mungonin mekanizmat dhe praktikat efikase për identifikimin e personave në nevojë për mbrojtje, si dhe gjetjen e vendit të origjinës të personave pa dokumentacion. Asnjë prej 682 kërkesave për azil të proceduara në mes viteve 2008 dhe dhjetor 2015 nuk ka përfunduar me miratimin e azilit. Gjashtë persona kanë marrë mbrojtje shtesë prej vitit 2008. UNHCR-ja e përshkoi integrimin e personave që kanë përfituar mbrojtje shtesë si sfidë të vazhdueshme përkundër përpjekjeve të qeverisë për ta hartuar një kornizë për këtë qëllim dhe mbështetjes ligjore dhe psikosociale të UNHCR-së. Problem i vazhdueshëm është edhe mungesa e shërbimeve të përkthimit për një numër gjuhësh të huaja.

Autoritetet i transferuan migrantët dhe refugjatët e kapur në kufijtë e vendit në qendrën për azil të vendit. Vëzhguesit e pavarur kishin qasje në qendrën për azil. UNHCR-ja raporti se azilkërkuesit kishin akomodim, shujta të rregullta dhe veshmbathje që siguroheshin nga qendra, si dhe vlerësim psikologjik, shërbime këshillimi dhe ndihmë ligjore.

Si reagim ndaj krizës së shfaqur rajonale të refugjatëve gjatë vitit, UNHCR-ja dhe Organizata Ndërkombëtare për Migrim punuan ngushtë me qeverinë për përgatitjen e reagimit adekuat në rast të dyndjes së refugjatëve dhe migrantëve. Ky proces i planifikimit vuri në pah se vendit do t'i duheshin burime domethënëse të jashtme për t'i përmbushur nevojat e njerëzve në transit dhe azilkërkuesve në rast të ndonjë dyndjeje në Kosovë.

## Personat pa shtetësi

Shifrat zyrtare për persona pa shtetësi nuk ishin në dispozicion. Ligji nuk përmban dispozita diskriminuese, të cilat mund të shkaktojnë që grupeve apo individëve t'u hiqet apo mohohet shtetësia. Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit apo prej lindjes në vend. Në prill, Ministria e Punëve të Brendshme nxori një udhëzim administrativ për vendosjen e procedurave për përcaktimin e statusit të pa shtetësisë për natyralizimin e personave pa shtetësi dhe refugjatëve. Procedurat parashohin qasje në natyralizim për personat që marrin statusin e personit pa shtetësi apo të refugjatit pesë vjet pas paraqitjes së kërkesës.

Ligji parashikon lëshimin e dokumenteve të udhëtimit për persona pa shtetësi. Edhe pse ligjet që kanë të bëjnë me gjendjen civile u mundësojnë t'i regjistrojnë lindjet, martesat dhe vdekjet, zbatimi i tyre ndryshonte nga komuna në komunë, varësisht nga dallimet në kapacitet apo interpretimet e ndryshme të ligjit. Kapaciteti për t'i identifikuar personat pa shtetësi dhe personat me shtetësi të papërcaktuar mbeti joadekuat.

Deri në nëntor, UNHCR-ja ndihmoi 656 romë të Kosovës, ashkalinj të Kosovës dhe egjiptianë të Kosovës të paregjistruar. Anëtarët e paregjistruar të familjeve nuk merrnin ndihma sociale, nuk kishin të drejtë në pension dhe nuk mund të regjistroheshin si titullarë të pronës apo të bartnin të drejta mbi pronën e trashëguar apo të transferuar. Fëmijët e lindur nga prindërit e zhvendosur jashtë vendit dhe që hynin me prindërit e tyre të pranuar sërish në vend shpesh nuk kishin dokumente, përfshirë edhe certifikata të lindjes, nga vendi i lindjes. Autoritetet e pranuan se ky përbënte problem, por nuk dolën me ndonjë zgjidhje sistematike.

Më 24 qershor, Agjencia e Regjistrimit Civil, që vepron në kuadër të MPB-së, promovoi regjistrimin e lindjes pa pagesë dhe regjistrimin e vonshëm duke hequr datën e skadimit, që do të shkaktonte pagesa të taksave administrative dhe gjobave për shumë shërbime regjistrimi për romët e Kosovës, ashkalinjtë e Kosovës dhe egjiptianët e Kosovës.

Gjatë vitit, vendi bashkëpunoi me autoritetet e Malit të Zi për t'u lejuar rreth 350 romëve të Kosovës, ashkalinjve të Kosovës dhe egjiptianëve të Kosovës, të zhvendosur në Mal të Zi, për të aplikuar për dokumente identifikimi dhe për regjistrim të fëmijëve. Një ekip biometrik i MPB-së e vizitoi Malin e Zi disa herë për t'i regjistruar këta persona të zhvendosur. Sipas UNHCR-së, sigurimi i këtyre dokumenteve nga Kosova ka ndihmuar në mënyrë domethënëse rregullimin e statusit të këtyre personave të zhvendosur, duke kontribuar në parandalimin e pashtetësisë.

## Seksioni 3. Liria për pjesëmarrje në procesin politik

Ligji parashikon të drejtën e qytetarëve për ta zgjedhur qeverinë e tyre përmes zgjedhjeve periodike të lira e të drejta dhe ata e ushtruan këtë të drejtë përmes zgjedhjeve në bazë të votimit të përgjithshëm e të barabartë.

Qeveria serbe vazhdoi me shpërbërjen e strukturave paralele ilegale qeveritare në komunat veriore si pjesë e procesit për zbatimin e Dialogut të Brukselit mes Serbisë dhe Kosovës, por disa struktura mbetën. Institucionet paralele ilegale gjithashtu vazhduan të vepronin në enklavat serbe dhe gorane në tërë Kosovën jugore.

## Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike

Zgjedhjet e fundit: Zgjedhjet e dyta nacionale parlamentare të vendit që nga pavarësia, dhe të parat në të cilat përfshihej Kosova veriore, u mbajtën në qershor të vitit 2014. Vëzhguesit ndërkombëtarë dhe të pavarur e vlerësuan votimin në përgjithësi si të drejtë e të lirë. Në zgjedhje garuan 30 parti apo grupe politike.

Partitë politike dhe pjesëmarrja politike: Partitë politike vepronin pa kufizim apo ndërhyrje të jashtme. Lidhja partiake luante rol të madh në qasje në shërbime qeveritare e sociale dhe në mundësi për punësim. Besnikëritë klanore gjithashtu luanin rol të madh në organizatat politike.

Anëtarët e partive opozitare Vetëvendosje, Nisma dhe AAK përdorën gazin lotsjellës, sprejin djegës dhe predha brenda sallës së Kuvendit për t'i sulmuar anëtarët e qeverisë dhe deputetët në raste të shumta në tetor, nëntor dhe dhjetor. Ata publikisht deklaruan se qëllimi i tyre ishte ta bllokonin debatin dhe miratimin e ligjeve. Në reagim, autoritetet i akuzuan disa deputetë për posedim të armëve, shkaktim të rrezikut të përgjithshëm dhe/ose pengim të personave zyrtar për kryerjen e detyrave të tyre.

## Seksioni 4. Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në Qeveri

Ligji parashikon dënime penale për korrupsion nga zyrtarët; por Qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efikase dhe korrupsioni mbeti problem i rëndë. Mungesa e mbikëqyrjes efektive gjyqësore dhe dobësia e përgjithshme në sundimin e ligjit i kontribuuan këtij problemi.

Korrupsioni: Agjencia e Kosovës kundër Korrupsionit (AKK) dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ndanë përgjegjësinë për luftimin e korrupsionit në qeveri. Deri në gusht, AKK-ja pranoi më shumë se 160 raporte me pretendime për korrupsion, 120 prej të cilave kishin të bënin me konflikt të interesit. Prej raporteve të shqyrtuara, AKK-ja i dërgoi 70 raste për ndjekje penale, kurse katër raste kundër 12 personave i dorëzoi në polici. AKK-ja i mbylli 80 raste prej vitit 2015 dhe viteve të mëparshme për shkak të mungesës së provave.

Dënimi për akuza të korrupsionit vazhdoi të paraqiste një proporcion të vogël të personave të hetuar dhe të akuzuar. Më 28 shtator, Prokurori i EULEX-i në zyrën e Prokurorit Special parashtroi një aktakuzë të ndryshuar, duke kombinuar aktakuza të mëhershme për korrupsion prej vitit 2012 dhe 2014 kundër shtatë individëve. Në to përfshihej kryetari i partitë politike Nisma për Kosovën dhe ish-ministri i Transportit, Fatmir Limaj, truproja e Limajt Shpëtim Telaku, ish-

shefi i prokurimit në Ministrinë e Transportit, Nexhat Krasniqi, pronari i ndërmarrjes Tali, Florim Zuka dhe ish-shefi i kabinetit të Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala. Të pandehurit akuzoheshin për pjesëmarrje në krim të organizuar, abuzim të pozitës apo autoritetit zyrtar, keqpërdorim të autorizimeve ekonomike, marrje të ryshfetit dhe akuza të tjera në lidhje me korrupsion.

Gjatë vitit, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) auditoi Zyrën e Presidentit, shumicën e ministrive dhe Kuvendin. ZAP-i shqyrtoi menaxhimin dhe përgjegjësinë fiskale në qeverinë qendrore dhe në administratat komunale. Hetimet nga ZAP-i zbuluan disa shkelje të ligjit që e rregullon prokurimin publik dhe të rregulloreve që i rregullojnë financat publike.

Deklarimi financiar: Ligji i obligon të gjithë zyrtarët e lartë publikë dhe anëtarët e familjeve të tyre që ta deklarojnë pasurinë e tyre dhe prejardhjen e pasurisë së tyre në baza vjetore. Përveç kësaj, zyrtarët e lartë duhet t'i raportojnë ndryshimet në pasuri kur e fillojnë apo ndërpresin shërbimin e tyre në një funksion publik. AKK-ja administron këto të dhëna, verifikon zbulimet dhe i publikon ato në ueb-faqen e vet. Gjatë këtij viti, agjencia raportoi se 98,4 për qind e zyrtarëve e deklaruan pasurinë dhe të ardhurat e tyre. Kjo përqindje përfshinte zyrtarët në komunat veriore ku deklarimi i pasurisë u bë për herë të parë. Autoritetet mund t'i gjobisin zyrtarët e akuzuar për shkelje të vogla të kritereve apo t'ua ndalojnë ushtrimin e funksioneve publike deri në një vit. AKK-ja i dërgoi të gjitha kallëzimet penale kundër atyre që nuk e kishin deklaruar pasurinë te prokurorët.

Qasja publike në informata: Ligji parashikon qasje publike në informata qeveritare, por autoritetet nuk e zbatuan ligjin në mënyrë efikase. Organizatat e shoqërisë civile, të cilat i parashtruan shumicën e kërkesave për informata, raportuan se institucionet qeveritare rrallëherë ua dhanë informatat e kërkuara ose nuk pranuan ekzistencën e dokumentit të cekur që ato e kishin kërkuar.

Gjykatat rrallëherë i pranonin paditë kundër institucioneve që i shpërfillnin kërkesat për dokumente dhe organizatat e shoqërisë civile e konsideronin këtë mungesë të pasojave si pengesë për efikasitetin e ligjit. Thuhet se zyrtarët nganjëherë i refuzonin kërkesat e tyre mbi bazën që dokumentet përmbanin informata të klasifikuara apo sekrete pa ia dhënë kërkuesit emrin e institucionit që i klasifikonte dokumentet apo numrin e rastit.

**Seksioni 5. Qëndrimi qeveritar në lidhje me hetimin ndërkombëtar dhe joqeveritar të shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut**

Një numër i madh i grupeve vendëse dhe ndërkombëtare për të drejta të njeriut në përgjithësi punuan pa u kufizuar nga qeveria, duke hetuar dhe publikuar konkluzionet e veta për rastet e të drejtave të njeriut. Qeveria bashkëpunonte dhe deri-diku reagonte ndaj pikëpamjeve të tyre.

Organet qeveritare për të drejta të njeriut: IAP-i ka kompetencë për t'i hetuar pretendimet për shkelje të të drejtave të njeriut dhe abuzim të autoritetit qeveritar, si dhe vepron si mekanizëm kombëtar parandalues kundër torturës. Në mënyrë parësore, IAP-i është përgjegjës për monitorimin e institucioneve të ndalimit dhe shtatë zyrtarët e IAP-it në terren ia mundësuan këtij institucioni mbajtjen e kontaktit me të gjitha komunat e vendit. Në rastet kur rekomandimet e IAP-it nuk përfillen, ai mund të ngrejë raste kundër organeve qeveritare në gjykatë, përfshirë edhe në Gjykatën Kushtetuese. Më 28 maj, Kuvendi nxori legjislacionin që i jep IAP-it autoritetin për të paraqitur raste në Gjykatën Kushtetuese në cilësinë e mikut të gjykatës *(amicus curiæ)*. Po ashtu, IAP-i mund të japë rekomandime mbi përshtatshmërinë e ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore ose administrative, udhëzimeve dhe praktikave. IAP-i raportoi se numri i ankesave të pranuara ishte shtuar për gjashtë për qind në gjashtë muajt e parë të vitit në krahasim me vitin 2014.

Shumica e vëzhguesve të të drejtave të njeriut konsideronin që emërimi i avokatit të ri të popullit më 2 korrik shtoi efikasitetin e IAP-it.

## Seksioni 6. Diskriminimi, abuzimet shoqërore dhe trafikimi i personave

Ligji në mënyrë të posaçme ndalon diskriminimin në bazë të seksit, gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, aftësisë së kufizuar mendore apo fizike, orientimit seksual, lidhjes ose bindjes politike, prejardhjes etnike, kombësisë, fesë apo besimit, racës, prejardhjes shoqërore, pronës, lindjes apo ndonjë karakteristike tjetër. Qeveria nuk i zbatonte gjithmonë këto ndalesa në mënyrë efikase.

### Femrat

Dhunimi dhe dhuna në familje: Ligji e konsideron dhunimin vepër penale, por nuk e trajton dhunimin bashkëshortor në mënyrë të posaçme. Sipas ligjit, dhunimi dënohet prej 2 – 15 vjet burg dhe dhunimi i të miturës (marrëdhënia seksuale me fëmijë nën moshën 16-vjeçare) dënohet prej 5 – 20 vjet burg. Dhunimi që përfshin vrasjen dënohet prej 10 vjet burg deri në burgim të përjetshëm.

EULEX-i vuri në pah se gjykatat shpesh shqiptonin dënime më të lehta se sa dënimi më i ultë ligjor për rastet e dhunimit, veçanërisht për rastet që përfshinin

të mitur. EULEX-i gjeti se gjykatat rrallë ndërmerrnin hapa për t'i mbrojtur viktimat dhe dëshmitarët dhe nuk i mbyllnin seancat dëgjimore për publikun siç kërkon ligji.

Dhuna në familje ngeli forma më e përhapur e dhunës në bazë gjinore. Mbrojtësit e viktimave pohonin se rastet nuk raportoheshin sa duhet për arsye të damkosjes shoqërore kundër raportimit të ngjarjeve të tilla jashtë familjes, mungesës së besimit në institucionet gjyqësore, qëndrimit tradicional shoqëror në një shoqëri të dominuar nga meshkujt dhe mungesës së opsioneve të duhura për viktimat.

Dënimet për dhunën në familje sillen prej gjashtë muaj deri në pesë vjet burgim. Ligji e trajton dhunën në familje si çështje civile përveç nëse viktima pëson lëndime trupore. Mosrespektimi i aktgjykimit të një gjykate civile që ka të bëjë me dhunën në familje është vepër penale dhe mund të ndiqet penalisht. Thuhej që policia reagoi me vend ndaj pohimeve për dhunim dhe dhunë në familje.

Kur viktimat ngrinin padi, njësitë policore për dhunë në familje kryenin hetime dhe ua kalonin rastet prokurorëve. Shkalla e ndjekjes penale ishte e ulët për shkak të faktorëve shoqërore, si dhe numrit të madh të lëndëve të pazgjidhura në gjykatat civile dhe penale. Mbrojtësit e viktimave dhe vëzhguesit e gjykatave pohuan se prokurorët dhe gjyqtarët parapëlqenin bashkimin e familjes më shumë se mbrojtjen e viktimave, ashtu që urdhrat mbrojtës nganjëherë ia lejonin kryesit të veprës të qëndronte në shtëpinë familjare derisa rasti ishte në pritje. Dënimet silleshin prej qortimeve gjyqësore deri në dënim me burg.

Ligji ua lejon individëve që ndjehen të kërcënuar të kërkojnë urdhër kufizimi, por shkelja e urdhrit të mbrojtjes rrallëherë solli akuzë penale. Gjykatat rrallë iu dhanë përsëritësve të veprave dënime më të larta siç kërkohet me ligj.

Më 23 tetor, Zejnepe Bytyqi Berisha nga Suhareka pretendohet se u vra nga bashkëshorti i saj, Nebi Berisha. Policia konfirmoi se në vitin 2002 bashkëshorti i saj ishte dënuar për dhunë në familje dhe ishte dënuar me gjashtë muaj me kusht dhe në vitin 2008 ishte shpallur fajtor dhe ishte gjobitur 300 euro (330 dollarë) për posedim të paligjshëm të armës. Sipas Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGK), Zejnepe Berisha e kishte raportuar bashkëshortin për dhunë në familje tetë herë.

Në bazë të politikave afatgjata për luftimin e dhunës në familje, rregulloret e reja hynë në fuqi që kërkojnë trajtim për varësi nga lëndët narkotike dhe alkooli për kryesit e veprave. Por, zbatimi i tyre mbeti i kufizuar si në nivel qendror, edhe në atë lokal.

Gjatë vitit Ministria e Drejtësisë filloi hartimin e strategjisë së re për luftimin e dhunës në familje, bazuar në rekomandimet e ekspertëve të jashtëm, të cilët kërkuan reforma ligjore që do ta bënin abuzimin vepër penale dhe do të kthenin fokusin në mbrojtjen e viktimave.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përfshiu një njësit kushtuar dhunës në familje. Akademia e Kosovës për Siguri Publike përfshiu kurse mbi të drejtat e njeriut dhe punën me viktima të dhunës në familje, të dhunimit dhe trafikimit të personave në të gjitha programet e veta të trajnimit themelor për kadetë të policisë.

Qeveria dhe donatorët ndërkombëtarë siguruan mbështetje për shtatë OJQ për të ndihmuar fëmijët dhe femrat viktima të dhunës në familje. Në Kosovë ishin 10 strehimore për viktimat e dhunës në familje.

Shumë zyrtarë morën pjesë në ngjarjet kushtuar individëve që ishin sulmuar seksualisht gjatë kohës së konfliktit në fund të viteve 1990-të, përfshirë edhe përmes Këshillit Kombëtar për të mbijetuarit e dhunës seksuale të Presidentes.

Ngacmimi seksual: Nuk ka ligj të posaçëm që trajton ngacmimin seksual. Sipas organizatave për të drejta të gruas, ngacmimi seksual në vend të punës ishte i rëndomtë dhe viktimat nuk e lajmëronin atë për shkak të frikës nga hakmarrja fizike apo largimi nga puna. Vetëdijesimi publik për ngacmimin seksual mbeti i ulët.

Të drejtat riprodhuese: Çiftet dhe individët kanë të drejtë të vendosin për numrin, shpeshtësinë dhe kohën kur të kenë fëmijë, ta menaxhojnë shëndetin e tyre riprodhues dhe kanë qasje dhe mënyra për të marrë informata pa diskriminim, detyrim apo dhunë. Qeveria në përgjithësi i respektoi të drejtat riprodhuese, por komunitetet e varfra, të margjinalizuara dhe të pashkolluara shpesh kishin qasje të kufizuar në informata, kurse qendrat e kujdesit për shëndet publik ofronin trajtim të kufizuar për të Kosovës.

Diskriminimi: Ligji parasheh status dhe të drejta të njëjta për gra sikurse për burra, përfshirë edhe sipas ligjeve për familjen, punën, pronën, nacionalitetin dhe për trashëgimi. Ligji kërkon paga të njëjta për punën e njëjtë. Statusi tradicionalisht më i ulët në familje i grave ndikoi në trajtimin e tyre brenda sistemit ligjor.

Ligji përcakton që partnerët në martesë dhe bashkësi civile kanë të drejta të barabarta për të poseduar dhe trashëguar, por meshkujt rëndom e trashëgonin pronën e familjes dhe vetëm 8 për qind e grave posedonin tokë. Sipas ligjit që rregullon çështjet e trashëgimisë dhe familjare, pas vdekjes, pasuria e të

ndjerit/es ndahet në mënyrë të barabartë në mes të bashkëshortit/es dhe fëmijëve, kurse të afërmit e shkallës së dytë e trashëgojnë pronën vetëm nëse të gjithë të afërmit e shkallës së parë kanë vdekur. Në rast të testamentit, gjinia nuk mund të përdoret si kusht për kufizimin e trashëgimisë. Në raste të rralla, vejushat shqiptare të Kosovës, posaçërisht në zonat rurale, rrezikonin ta humbnin kujdestarinë e fëmijëve të vet për shkak të një zakoni i cili kërkonte që fëmijët dhe prona t'i kaloheshin familjes së babait të ndjerë, ndërsa vejusha të kthehej në familjen e saj amnore.

Relativisht pak femra fituan pozita udhëheqëse të nivelit të lartë në biznes, polici apo Qeveri. Femrat përbënin më pak se 48 për qind të fuqisë punëtore të sektorit publik në vitin 2014. Sipas Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, femrat posedonin ndërmjet 15-17 për qind të të gjitha bizneseve të regjistruara (shih Seksionin 7.d.).

Përzgjedhja e seksit mbi baza gjinore: Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2012, data e regjistrimit të fundit të popullsisë, raporti gjinor mes meshkujve dhe femrave të lindur në vend ishte 110.7 me 100. Sipas Fondit të OKB-së për Fëmijët (UNICEF), qeveria nuk ndërmori hapa për ta adresuar këtë çekuilibrim, si p.sh. duke nxjerrë rregullore për klinikat private apo duke ndihmuar për rritjen e statusit shoqëror të grave.

**Fëmijët**

Regjistrimi i lindjeve: Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit e vet apo për shkak të lindjes në vend. Sipas Anketës së Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitet 2013-2014, ishte regjistruar lindja e 88 për qind të fëmijëve nën moshën pesë vjeçare. Mungesa e regjistrimit në përgjithësi nuk ndikonte në mundësinë e fëmijëve për shkollim fillor apo kujdes shëndetësor. Sipas UNICEF-it, mosregjistrimi mund të kishte ndikim negativ në qasjen në ndihma sociale, veçanërisht për fëmijët e riatdhesuar. Fëmijët e paregjistruar ishin pa shtetësi.

Abuzimi i fëmijëve: Abuzimi i fëmijëve ishte problem. Më 17 qershor, IPK-ja filloi një hetim ndaj oficerëve policorë nga njësiti patrullues i Suharekës, të cilët pretendohej se kishin rrëmbyer dhe dhunuar dy vajza të moshës 14 dhe 15 vjeçare. IPK-ja rrjedhimisht dërgoi rastin për tetë oficerë policorë për mundësi të ndjekjes penale nën akuzat për abuzim seksual të personit të mitur, abuzim të detyrës zyrtare, kërcënim dhe shfrytëzim të ndikimit.

Gjatë vitit, UNICEF-i gjeti se 30 për qind e fëmijëve në vend dhe 40 për qind të fëmijëve nga radhët e romëve të Kosovës, ashkalinjve të Kosovës dhe egjiptianëve të Kosovës ishin viktima të abuzimit. UNICEF-i besonte që ky

problem nuk raportohej sa duhej për shkak të shkallës së ultë të vetëdijesimit publik për abuzimin e fëmijëve, mungesës së shërbimeve për viktima dhe mundësisë së kufizuar të autoriteteve për t'i identifikuar, raportuar dhe referuar rastet e abuzimit.

Sipas MICS-it, 61 për qind e fëmijëve nën moshën 14 vjeçare i ishin nënshtruar "agresionit psikologjik" ose ndëshkimit fizik nga anëtarët e familjes gjatë muajit para anketës.

Martesa e hershme dhe e detyruar: Ligji lejon që personat të martohen ligjërisht në moshën 16-vjeçare. Martesa e fëmijëve ishte e rrallë, por vazhdoi të praktikohej në disa komunitete, përfshirë romët, ashkalinjtë, egjiptianët dhe goranët e Kosovës. Sipas një MICS-i të veçantë që ishte përqendruar në këto komunitete, 11.6 për qind e fëmijëve, shumica vajza, martohej para moshës 15 vjeçare. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Agjencia për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit mbajtën fushata informimi për ta shkurajuar këtë fenomen.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve: Mosha minimale për marrëdhënie seksuale me pëlqim është 16 vjeç. Dhunimi i të miturës është vepër penale që, varësisht nga rrethanat dhe mosha e viktimës, dënohet prej 5 – 20 vjet burg. Ligji ndalon posedimin, prodhimin dhe shpërndarjen e pornografisë së fëmijëve. Personat që prodhojnë, përdorin apo përfshijnë një fëmijë në krijimin apo prodhimin e pornografisë dënohen prej një deri në pesë vjet burg. Shpërndarja, promovimi, transmetimi, ofrimi apo paraqitja e pornografisë së fëmijëve dënohet prej gjashtë muaj deri në pesë vjet burg. Posedimi ose prokurimi i pornografisë së fëmijëve dënohet me të holla apo me burg deri në tri vjet.

Rrëmbimet ndërkombëtare të fëmijëve: Vendi nuk është nënshkrues i Konventës së Hagës së vitit 1980 për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës. Për më shumë informata shih travel.state.gov/content/childabduction/en/legal/compliance.html.

**Antisemitizmi**

Sipas Komunitetit Hebraik të Kosovës, në vend jetojnë 54 hebrenj. Më 20 qershor, Komuniteti Hebraik i Kosovës raportoi se ishte shkatërruar pllaka metalike me Yllin e Davidit në selinë e komunitetit të tyre në Prizren. Policia nuk arrestoi asnjë person.

**Trafikimi i personave**

Shih *Raportin mbi Trafikimin e Personave* të Departamentit të Shtetit në: www.state.gov/j/tip/rls.tiprpt/.

**Personat me aftësi të kufizuara**

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara fizike, ndijore, intelektuale dhe mendore në punësim, shkollim, transportim, kujdes shëndetësor apo shërbime të tjera shtetërore. Qeveria nuk i zbatoi në mënyrë efikase këto dispozita dhe personat me aftësi të kufizuara hasën në diskriminim të madh (shih Seksionin 7.d).

Personat me aftësi të kufizuara kishin të drejtë në disa pagesa të vogla të ndihmës sociale nga qeveria. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe ka përgjegjësinë për menaxhimin e pagesave të ndihmës sociale dhe pensioneve për personat me aftësi të kufizuara.

Komisioni shëndetësor, duke vepruar nën Ministrinë e Punës, ua hoqi pensionet për aftësi të kufizuara 1000 anëtarëve të komunitetit të personave me paaftësi në të dëgjuar, të cilët kishin marrë përfitime prej vitit 2004. BE-ja kritikoi autoritetet për heqjen e pensioneve për paaftësi pa arsyetim. BE-ja po ashtu shprehu shqetësim për mungesën e asistentëve personalë për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Sipas raportit të progresit të BE-së për këtë vit, ndihma shëndetësore dhe sociale për personat me aftësi të kufizuara mbeti e pamjaftueshme dhe qasja fizike në institucionet publike mbeti sfidë.

Organizata për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, HandiKos, raportoi që personave me lëndime të boshtit kurrizor, distrofi muskulore, sindromën Down dhe sklerozë të shumëfishtë iu mungonte qasja në shërbime themelore, në ndihmë sociale dhe punësim.

Ligji për shëndetin mendor hyri në fuqi më 8 dhjetor. Ky ligj rregullon vendosjen e personave në institucionet për përkujdesje psikiatrike ose shoqërore dhe i mbron të drejtat e tyre brenda institucioneve të tyre. Ministria e Punës dhe Ministria e Shëndetësisë kishin mandate të ndara për trajtimin e personave që merreshin me probleme të shëndetit mendor. Deri në tetor, Ministria e Shëndetësisë drejtonte nëntë shtëpi për integrim dhe të përbashkëta për personat me aftësi të kufizuara mendore, kurse Ministria e Punës i drejtonte tetë të tjera. OJQ-ja Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) theksoi se objektet e shëndetit mendor ishin nën standarde, edhe pse qeveria kishte rinovuar disa prej tyre gjatë vitit. Objektet në vend nuk kishin staf

të përshtatshëm, si psikiatër, psikologë, punëtorë socialë, fizioterapeutë dhe ekspertë të tjerë teknikë.

QKRMT-ja raportoi se disa persona me aftësi të kufizuara mendore ishin në qendra të ndalimit pa bazë ligjore, por theksoi se gjykatat po i shqyrtonin disa raste. QKRMT-ja vuri në pah se objektet dhe trajtimi i të burgosurve me aftësi të kufizuara mendore mbetej nën standarde (shih Seksionin 1.c.).

**Pakicat kombëtare/raciale/etnike**

Pakicat etnike, ku përfshiheshin komunitetet serbe, rome, ashkali, egjiptiane, turke, boshnjake, gorane, kroate dhe malazeze, ballafaqoheshin me shkallë të ndryshme të diskriminimit institucional dhe shoqëror në fushat si punësimi (shih seksionin 7.d.), arsimi, shërbimet sociale, përdorimi i gjuhës, liria e lëvizjes, e drejta për t'u kthyer në shtëpi të veta (për persona të zhvendosur) dhe të drejta të tjera themelore. Anëtarët e komuniteteve rome, ashkalinj dhe egjiptiane të Kosovës vuanin nga diskriminimi i përhapur shoqëror dhe ekonomik. Atyre shpesh u mungonte qasja në higjienë themelore, kujdes mjekësor dhe shkollim dhe vareshin me të madhe nga ndihmat humanitare për mbijetesë.

Incidentet ku përfshihej dhuna kundër serbëve të Kosovës që përpiqeshin të kthehen në vend vazhduan, posaçërisht në rajonet e Pejës, Istogut dhe Klinës. Në 11 muajt e parë të vitit pati mbi 254 incidente të vjedhjes, grabitjes, ngacmimit verbal dhe dëmtimit të pronës së serbëve të Kosovës dhe të kishës ortodokse serbe. Shqiptarët etnikë nganjëherë përdorën dhunën për t'i parandaluar serbët etnikë për të marrë pjesë në shërbimet fetare në zona të caktuara (shih Seksionin 2.d.).

Deri në shtator, 33 krime kundër komunitetit boshnjak të Kosovës u raportuan në rajonin e Pejës dhe të Prizrenit, përfshirë vjedhje të shënjestruara, kërcënime, sulme dhe dëmtim të e pronës. Njëzet krime u raportuan kundër komunitetit goran të Kosovës në zonën e Dragashit, përshirë dëmtim të pronës, vjedhje, sulme fizike dhe kërcënime. Po ashtu, u raportuan sulme edhe kundër pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkalinj dhe egjiptianë të Kosovës në komunat e Pejës, Ferizajit, dhe Mitrovicës së Veriut dhe të Jugut.

Gjendja e sigurisë në veri të vendit u përmirësua, por mbeti e paparashikueshme. Pati disa raste të djegieve të veturave, eksplodimeve, vjedhjeve dhe dëmtimit të pronës. Edhe pse policia theksoi se shumica e incidenteve ishin incidente të brendshme brenda komunitetit serb të Kosovës dhe nuk ishin të motivuara në aspektin etnik, megjithatë pati konfrontime etnike ndërmjet të rinjve serbë dhe shqiptarë të Kosovës urës së Ibrit. Në prill pati një numër të përleshjeve të dhunshme ndëretnike në Mitrovicën e Veriut.

Përpjekjet për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara gjatë ose pas luftës në lagjen e përzier etnike, Kroi i Vitakut u shtynë për shkak të një mosmarrëveshjeje ndëretnike në lidhje me kufirin administrativ ndërmjet komunave të Mitrovicës së Veriut dhe të Jugut. Në maj, kryetarët e të dy komunave formuan një grup punues për t'i zbutur tensionet. Në të përfshiheshin përfaqësuesit e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe të lagjes. Grupi punues u takua periodikisht, por me pak sukses. Në pajtim me marrëveshjen e 25 gushtit prej dialogut, kryetarët e komunave të Mitrovicës së Veriut dhe të Jugut dhe BE-ja diskutuan për vijat administrative në mes të komunave, por pa marrëveshje.

Komisionari për gjuhë vazhdoi të monitoronte dhe raportonte mbi zbatimin e legjislacionit që u jepte status të barabartë dy gjuhëve zyrtare të vendit, shqipes dhe serbishtes. Komisionari pranoi një sërë ankesash, përfshirë ankesat që paketimet farmaceutike nuk ishin në dispozicion në gjuhën shqipe dhe formularët tatimorë nuk ishin në dispozicion në gjuhën serbe. Ndonëse institucionet qeveritare mund të gjobiten për mosrespektim të kritereve gjuhësore, nuk pati raportime për gjobitje. Komisionari nuk kishte kompetenca të drejtpërdrejta për zbatim. Shumica e institucioneve qeveritare nuk ofronin sasi të barabarta të informatave online në gjuhë të tjera përveç në gjuhën shqipe. Serbët e Kosovës u ankuan që përkthimi në gjuhën serbe i ligjeve, dokumenteve të tjera zyrtare dhe ueb-faqeve të qeverisë ishte i dobët edhe pse versionet e ligjeve në shqip dhe serbisht kanë rëndësi të njëjtë.

Boshnjakët e Kosovës i mirëpritën ndryshimet e ligjit që ua mundëson boshnjakëve, romëve dhe turqve të përzgjedhin që dokumentet e identifikimit t'iu lëshohen në gjuhën e tyre amtare.

Përfaqësuesit e komunitetit turk shprehën pakënaqësi lidhur me zbatimin e ligjit mbi gjuhët, posaçërisht në komunën e Prizrenit, ku gjuha turke është gjuhë zyrtare. Zyrtarët pohuan që përkthimi i emrave të rrugëve dhe i dokumenteve personale mungonte ose ishte i dobët. Të meta të ngjashme ndodhën në komunat në të cilat gjuha boshnjake dhe rome kanë status zyrtar, edhe pse më 18 janar, Komisioni Qendror Zgjedhor për herë të parë ofroi fletëvotimet dhe materialin zgjedhor në gjuhën rome të vendit gjatë një zgjedhjeje të jashtëzakonshme lokale.

Punësimi i pakicave në institucione publike mbeti i kufizuar dhe në përgjithësi kufizohej në nivele më të ulëta të Qeverisë. Qeveria nuk pati mekanizma efektivë për monitorimin e niveleve të punësimit të pakicave në institucione publike.

Ligji kërkon kushte të barabarta për nxënës, pavarësisht nga gjuha amtare dhe parashikon të drejtën për shkollim publik në gjuhën amtare për nxënës të pakicave, deri në mbarim të shkollës së mesme. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe disa organizata ndërkombëtare raportuan që shkalla e regjistrimit në shkollë ishte më e ulëta ndër komunitetet pakicë jo-serbe. Fëmijët romë, ashkalinj dhe egjiptianë të Kosovës vuanin nga shkalla e ulët e regjistrimit, shkalla e lartë e braktisjes së shkollës dhe nivelet e dobëta të të nxënit.

Të gjitha pakicat ankoheshin se qeveria nuk ua siguroi tekstet shkollore nxënësve jo-shqipfolës në cilido nivel të shkollimit. Sipas Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, shkollat që mësimin e mbanin në gjuhën serbe importonin tekste shkollore nga Serbia që nuk ishin në pajtim me dispozitat e kurrikulës vendore.

Mësimet në Universitetin e Prishtinës, universitetin më të madh në vend, mbahen vetëm në gjuhën shqipe. Sipas Ministrisë së Arsimit, Universiteti i Prishtinës nuk ofroi provimin pranues për studentë në gjuhën serbe, siç kërkohet me ligj. Edhe pse universitetet publike rezervuan vende për pakicat jo-serbe, autoritetet nuk ia dolën t'i mbushnin ato vende dhe e zvogëluan numrin e vendeve të rezervuara deri në 90 për qind gjatë vitit.

Mosnjohja nga qeveria e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, i cili punon sipas sistemit të qeverisë serbe, ishte pengesë kryesore për punësimin e serbëve të Kosovës dhe të pakicave të tjera në institucione qeveritare.

**Aktet e dhunës, diskriminimi dhe abuzimet e tjera të bazuara në orientim seksual dhe identitet gjinor**

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e drejtpërdrejtë ose indirekt të bazuar në orientim seksual dhe identitet gjinor në punësim, kujdes shëndetësor dhe edukim pas miratimit më 28 maj të amendamenteve të Ligjit kundër diskriminimit.

Kur motivimi për krim është i bazuar në gjini, orientim seksual apo lidhje të perceptuar të viktimës me personat që janë objekt i armiqësisë së tillë, ligji e konsideron atë motiv si rrethanë rënduese.

Një Grup Këshillëdhënës dhe Koordinues, i përbërë nga përfaqësues të tetë ministrive, Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe tri OJQ-ve të LGBTI bashkëpunuan për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e komunitetit LGBTI. Ky grup takohej dy herë në vit dhe në maj u pajtua për Planin e parë kombëtar të veprimit për të

drejtat e LGBT-së. Por, grupi nuk kishte kompetenca për zbatimin e vendimeve të veta.

Qeveria ndërmori hapa për ta sinjalizuar mbështetjen e saj për të drejtat e LGBTI-së duke sponsorizuar dhe marrë pjesë në disa ngjarje publike, si në Paradën e Krenarisë në Ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë, që u mbajt për herë të dytë dhe që ishte më parada më e madhe në historinë e vendit. Qeveria po ashtu ndriçoi ndërtesën kryesore të Qeverisë me ngjyrat e ylberit.

Një pjesëtar i Qendrës për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, një OJQ që punon me komunitetin LGBTI, parashtroi një ankesë për diskriminim në Njësitin për të Drejta të Njeriut në Prishtinë kundër një zyrtari të komunës me pretendimin se e kishte diskriminuar atë për shkak të orientimit të tij seksual. Deri në dhjetor, nuk pati raporte të ndërmarrjes së veprimit nga komuna për këtë rast.

Sipas OJQ-ve që merren me të drejtat e njeriut, komuniteti LGBTI u përball me diskriminim të fshehtë në punësim, strehim, përcaktim të pa shtetësisë dhe qasje në shkollim dhe kujdes shëndetësor. OJQ-të thanë se trysnia shoqërore i bindi shumicën e personave LGBTI ta fshehin orientimin e tyre seksual ose identitetin gjinor. OJQ-të raportuan se diskriminimi i drejtuar ndaj LGBTI-ve shpesh kalonte pa u raportuar, duke pretenduar se policia nuk ishte e ndjeshme ndaj nevojave të komunitetit të tyre. Sipas OJQ-ve, deri në dhjetor, personat LGBTI kishin raportuan 13 krime të urrejtjes prej pavarësisë së vendit më 2008, por asnjë raport nuk kishte rezultuar me ngritje të aktakuzës.

### Turpi shoqëror për HIV dhe AIDS

Ndonëse nuk pati raportime të konfirmuara për diskriminim zyrtar ndaj personave me HIV/AIDS gjatë vitit, por pati raportime anekdotike për diskriminim të tillë.

### Dhuna ose diskriminimi tjetër shoqëror

Më 29 shtator, oficeri i policisë Valon Goxhuli u qëllua dhe u vra në komunën e Skenderajit. Policia e klasifikoi vrasjen me motive të gjakmarrjes që rezultoi nga një konflikt ndërmjet familjes së viktimës dhe familjes së vrasësit të dyshuar. Policia dyshon se Maliq Ramadan Biringjiku është vrasësi. Deri më 11 dhjetor, i dyshuari nuk është kapur.

## Seksioni 7. Të drejtat e punëtorëve

## a. Liria e asociimit dhe e drejta për të negociuar kolektivisht

Ligji parashikon të drejtën e punëtorëve për të formuar dhe t'iu bashkuar sindikatave të pavarura dhe të drejtën për të bërë grevë. Ligji ndalon diskriminimin anti-sindikal dhe shkeljen e të drejtave të punëtorit për shkak të aktiviteteve të tij ose të saj sindikale. Ligji siguron rikthimin e punëtorëve të larguar nga puna për shkak të veprimtarisë sindikale, përfshirë për shërbime themelore. Ligji zbatohet njëlloj për të gjithë individët që punojnë në sektorin publik dhe privat, përfshirë migrantët e dokumentuar dhe punëtorët vendorë.

Autoritetet nuk e zbatuan ligjin e punës në mënyrë efektive. Sipas Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), burimet, inspektimet dhe masat mbrojtëse nuk ishin adekuate dhe gjobat ishin të pamjaftueshme. Deri në shtator, Inspektorati i Punës (IP) i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale lëshoi 182 gjoba që silleshin prej dënimeve jomonetare deri në 35.000 euro (38.500 dollarë). BSPK tha se këto gjoba nuk mjaftonin për t'i parandaluar shkeljet. Procedurat administrative dhe gjyqësore ishin të ngatërruara dhe u nënshtroheshin vonesave të gjata apo ankesave.

Sipas BSPK-së, Qeveria dhe punëdhënësit në vend në përgjithësi e respektuan të drejtën për të formuar dhe për t'iu bashkuar sindikatave në sektorin publik dhe privat. Problem mbeti ndërhyrja e partive politike në organizata tregtare dhe në të drejtat e punëtorëve individualë. Sipas zyrtarëve të sindikatës, punëtorët në sektorin publik zakonisht përballeshin me keqtrajtim, përfshirë ngacmimin seksual dhe humbjen e vendit të punës, për shkak të lidhjes së tyre me parti politike. Punëdhënësit nuk i respektonin gjithmonë të drejtat e organizatave të punëtorëve për të negociuar kolektivisht. BSPK raportoi se shumë punëdhënës të sektorit privat në përgjithësi i shpërfillën ligjet e punës të vendit. BSPK-ja raportoi për vështirësi të vazhdueshme në formimin e sindikatave për shkak të ndërhyrjes së punëdhënësve në shoqatat dhe sindikatat e punëtorëve, posaçërisht në sektorin bankar, të ndërtimtarisë dhe hotelier. Përfaqësues të këtyre sektorëve i thanë BSPK-së në kushte anonimiteti se punëdhënësit përdorën kërcënimin për ta penguar formimin e sindikatave. Inspektorati i Punës raportoi se nuk kishte marrë asnjë ankesë zyrtare për diskriminim ndaj punëtorëve që u përpoqën t'u bashkohen sindikatave gjatë vitit. BSPK-ja pohoi që Inspektorati nuk ishte plotësisht funksional për shkak të mungesës së buxhetit dhe të stafit.

## b. Ndalimi i punës së dhunshme apo të detyruar

Ligji i ndalon të gjitha format e punës së dhunshme apo të detyruar, por puna e dhunshme e fëmijës ndodhi gjatë vitit (shih Seksionin 7.c.).

Burimet e Qeverisë, përfshirë masat mbrojtëse, ishin të pamjaftueshme për të siguruar zbatim të ligjit, për t'i identifikuar dhe mbrojtur viktimat dhe për t'i hetuar pohimet për punë të dhunshme apo të detyruar. Gjatë këtij viti nuk pati hetime, ndjekje penale apo dënime për punë të dhunshme për shkak të, sipas Inspektoratit të Punës, burimeve joadekuate për ta hetuar këtë çështje. Dënimet silleshin prej pesë deri në 12 vjet burgim dhe gjoba deri në 500.000 euro (550.000 dollarë) dhe ishin mjaft të rrepta në krahasim me dënimet për krime të tjera të rënda. Deri në shtator, autoritetet nuk larguan asnjë viktimë nga puna e dhunshme gjatë vitit.

Shih gjithashtu *Raportin mbi Trafikimin e Personave* të Departamentit të Shtetit në: www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

**c. Ndalimi i punës së fëmijëve dhe mosha minimale për punë**

Mosha minimale për punë është 15 vjet, nëse puna e tillë nuk është e dëmshme për fëmijën apo nuk e pengon atë për ta vijuar mësimin. Nëse puna ka të ngjarë ta rrezikojë shëndetin, sigurinë apo moralin e të rinjve, mosha minimale ligjore është 18 vjet.

Rregulloret ndalojnë shfrytëzimin e fëmijëve në vend të punës, përfshirë punën e dhunshme apo të detyruar. Qeveria e mbajti një komision për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve për të ndërhyrë në rastet e punës së dhunshme ose të rrezikshme. Komisioni ishte i kufizuar për shkak të burimeve të pakta. Qeveria po ashtu mbajti në funksion Këshillin Kombëtar kundër trafikimit të personave që hetonte rastet e trafikimit të fëmijëve për punë. Më 25 shtator, Qeveria e emëroi Ministrin e Punëve të Brendshme, Skender Hysenin, koordinator nacional kundër trafikimit dhe më 6 tetor, Hyseni ia barti përgjegjësitë e koordinatorit Zëvendës-ministrit të Punëve të Brendshme, Milan Radojeviq.

Inspektorët menjëherë i njoftonin punëdhënësit kur i gjenin të miturit duke punuar në kushte të rrezikshme. Deri në nëntor, Ministria e Punës regjistroi 157 raste të të miturve që punonin në kushte të rrezikshme, 93 prej të cilëve u kthyen në shkolla me ndihmën e Qendrave për Punë Sociale. Prej 157 fëmijëve, 33 ishin përfshirë në veprimtari të paligjshme, 96 në kërkim lëmoshe dhe 14 punonin në deponi për grumbullimin e mbeturinave. Një punonte në një minierë, nëntë në hotele dhe katër ishin përfshirë në bujqësi. Ministria e Punës theksoi se bashkërenditja e mangët ndërmjet institucioneve të vendit dhe mungesa e një regjistri të centralizuar rezultoi në raportimin shumë të paktë të rasteve të vërteta. Sipas Ligjit të punës, inspektorët mund t'i gjobisin punëdhënësit prej 100 euro (110 dollarë) deri në 10.000 euro (11.000 dollarë) për shkak të detyrimit të një punëtori për të punuar në kushte të rrezikshme të

punës. Gjobat ishin të dyfishta për veprat penale të kryera kundër një të mituri. Zbatimi ishte i dobët për shkak të trajnimit joadekuat dhe burimeve të pamjaftueshme. Ligji parashikon ndëshkime shtesë për punëdhënësit dhe familjet që i angazhojnë fëmijët në praktika të punës ose që dështojnë t'i përmbushin detyrimet e tyre prindërore duke rezultuar në punësim të paligjshëm të të miturit. Nëse përcaktohet që është në interesin më të mirë të fëmijës, ligji ua lejon autoriteteve ta largojnë një fëmijë nga shtëpia.

Koalicioni për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF) raportoi se fëmijët që punojnë në bujqësi dhe në sektorin e minierave hasnin në rreziqe që lidheshin me përdorimin e pajisjeve bujqësore dhe nxjerrjen e mineraleve nga vendet në të cilat arrihej me vështirësi. KOMF-i gjithashtu raportoi se numri i përgjithshëm i fëmijëve lypsarë nuk dihej. Ndonëse shumica e fëmijëve rrallëherë ishin siguruesit kryesorë të të ardhurave për familjet e tyre, puna e fëmijës shërbeu si kontribut i madh në të ardhurat e disa familjeve.

Fëmijët e rinj në zonat rurale shpesh u ndihmonin familjeve të veta në punë bujqësore, madje edhe gjatë orarit të mësimit. Fëmijët e qytetit shpesh punonin në një sërë punësh jozyrtare në ndërtimtari dhe të shitjes me pakicë, si shitja e gazetave, cigareve dhe kartelave të telefonit në rrugë. Disa fëmijë gjithashtu merreshin me punë fizike, si transportimi i mallrave.

Shih *Konkluzionet mbi format më të këqija të punës së fëmijës* të Departamentit të Punës në: www.dol.gov/ilab/reports/child-labor/findings/.

### d. Diskriminimi në lidhje me punësimin ose profesionin

Ligji ndalon çdo lloj diskriminimi, përfshirë përjashtimin ose parapëlqimin në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, moshës, gjendjes familjare, mendimit politik, prejardhjes nacionale apo sociale, gjuhës, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, gjendjes shëndetësore, shtatzënisë, trashëgimisë gjenetike apo anëtarësimit në sindikatë, që ndikon në anulimin ose dëmtimin e barazisë së mundësisë ose trajtimit në ndërtimin e kapaciteteve në punësim ose profesion. Ligji posaçërisht ndalon diskriminimin në bazë të gjinisë ose identitetit gjinor dhe vlen për qasje në punësim, vetëpunësim dhe zgjedhje të profesionit. Ndalimet përfshijnë diskriminimin në kushtet për gradim dhe rekrutim në cilëndo degë të aktivitetit dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale. Gjobat në rastet e diskriminimit sillen ndërmjet 500 deri në 10.000 euro (550 deri 11.000 dollarë). Ligji nuk mbron nga diskriminimi në bazë të statusit HIV apo sëmundjeve të tjera ngjitëse. Sipas OJQ-së Instituti GAP, dënimet ishin adekuate, por numri i inspektorëve të punës ishte i pamjaftueshëm që sistemi të funksiononte si duhej.

Diskriminimi në punësim dhe profesion ndodhi në lidhje me seksin, gjininë, identitetin gjinor, aftësinë e kufizuar dhe statusin minoritar (shih Seksionin 6). Gjatë vitit, BSPK-ja pranoi raporte prej sindikatave të punës dhe individëve që pohonin për diskriminim në bazë të moshës dhe gjendjes familjare. BSPK-ja vuri në pah se punësimi varej pothuaj ekskluzivisht nga statusi dhe lidhja politike e punëtorit. BSPK-ja gjithashtu theksoi se për shkak të papunësisë së lartë, punëtorët ngurronin ta raportonin diskriminimin, duke iu frikësuar hakmarrjes nga punëdhënësi i tyre. Punëtorët më së shpeshti i trajtonin çështjet e tyre të punës brenda dhe jozyrtarisht me punëdhënësit e tyre. BSPK-ja gjithashtu raportoi raste kur punëdhënësit i diskriminuan kandidatet femra gjatë intervistave për punësim dhe i përjashtonin në mënyrë të paligjshme gratë për shkak të shtatzënisë ose për shkak se kërkonin pushim të lehonisë.

Sipas ligjit, të huajt duhet të marrin leje për punë para se të kërkojnë të punojnë në vend. Sipas Inspektoratit të Punës ë, nuk pati raportime që punëtorëve të huaj u ishin mohuar lejet e punës dhe nuk pati raportime që të drejtat e punëtorëve të huaj ishin shkelur gjatë vitit.

**e. Kushtet e pranueshme të punës**

Rroga minimale e caktuar nga qeveria ishte 130 euro (143 dollarë) në muaj për punëtorët nën moshën 35-vjeçare dhe 170 euro (187 dollarë) në muaj për punëtorët mbi moshën 35-vjeçare e më të vjetër. Për punëtorët që fitojnë më pak se paga mesatare, ligji mundëson përfitime mujore deri në 120 euro (132 dollarë) për familjet pa burime të mjaftueshme dhe deri në 40 euro (44 dollarë) në muaj për individë. Familjet dhe individët mund të kishin zbritje në rrymë elektrike deri në 400 kW/h dhe kujdes shëndetësor falas.

Ligji parashikon javën standarde të punës prej 40 orësh, kërkon periudha pushimi, kufizon numrin e orëve të rregullta të punës deri në 12 orë në ditë, kufizon punën jashtë orarit deri në 20 orë në javë dhe 40 orë në muaj, kërkon pagesën shtesë për punën jashtë orarit dhe ndalon punën e tepërt e të detyrueshme jashtë orarit. Ligji parashikon 20 ditë pushim me pagesë në vit për punëtorë dhe 12 muaj të pushim pjesërisht të paguar të lehonisë. Ligji i punës i përcakton standardet e shëndetit dhe të sigurisë për vende të punës dhe qeveris me të gjitha industritë në vend.

Inspektorët e punës ishin përgjegjës për zbatimin e standardeve të punës, shëndetit dhe sigurisë, ndonëse 51 inspektorët e punësuar gjatë vitit nuk mjaftuan për ta monitoruar me efikasitet sektorin zyrtar dhe jozyrtar. Deri në nëntor, këta inspektorë kryen 8.703 inspektime të rastit dhe të planifikuara. Inspektorët e punës i këshilloi punëdhënësit mbi përmirësimet për të vepruar në pajtim me rregulloret në vend të punës dhe shkeljet që do të mund të rezultonin

në sanksione zyrtare. Deri në nëntor, Inspektorati shqiptoi 972 vërejtje për shkelje të ndryshme të standardeve të punës dhe dha 193 gjoba shtesë deri në 35.000 euro (38.500 dollarë) për moskorrigjim të shkeljeve të cituara. Deri në shtator, Inspektorati pranoi 259 ankesa kundër gjobave dhe vërejtjeve të shqiptuara nga inspektorët e punës. Inspektorati i Punës i zgjodhi këto ankesa brenda 15 deri në 60 ditë. Inspektorati vlerësoi se do t'i nevojiteshin 150 inspektorë për t'i monitoruar punëdhënësit në mënyrë adekuate ose për të ndikuar në zbutjen e problemeve të punës. Inspektorati i konsideronte gjobat financiare të pamjaftueshme për t'i dekurajuar shkeljet.

Sipas Inspektoratit të Punës dhe BSPK-së, ligji i punës është gjithëpërfshirës dhe dispozitat e tij sigurojnë mekanizma adekuatë për mbrojtje të barabartë të punëtorëve në sektorin publik dhe privat. Sipas BSPK-së, mungesa e zbatimit të ligjit nga qeveria ishte rrjedhojë e numrit të pakët të punëtorëve të sindikatës, si dhe e kufizimeve në burime dhe kapacitet të Inspektoratit të Punës.

Në janar, Ministria e Punës shtyu zbatimin e kontratës kolektive, të sponsorizuar nga qeveria, për shkak të ndryshimeve të domosdoshme në dispozitat e Ligjit të Punës në Kosovë. Kontrata kolektive i përcakton të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të punëtorit, përfshirë dispozitat mbi orët e punës, punën e natës, pushimin vjetor, pushimin e lehonisë, sigurinë në punë dhe beneficionet shëndetësore të punëtorit. Kontrata gjithashtu përfshin të gjitha mbrojtjet e parapara në ligje të punës dhe vlen për të gjithë punëtorët në ekonominë zyrtare dhe jozyrtare. Vëzhguesit theksuan se marrëveshja kishte për qëllim ta reduktonte ekonominë jozyrtare duke i ndëshkuar punëdhënësit që nuk i regjistronin punëtorët.

Sipas BSPK-së, punëdhënësit dështonin t'i respektonin standardet zyrtare të punës të cilat siguronin standarde të barabarta të mbrojtjes për punëtorët në sektorin publik dhe privat. BSPK-ja raportoi mungesë të mbikëqyrjes qeveritare dhe të zbatimit, posaçërisht lidhur me javën standarde të punës dhe punën e detyrueshme e të papaguar jashtë orarit. Shumë individë punonin me orar të gjatë në sektorin privat, kinse sipas dëshirës së tyre, pa kontratë pune, pagesë të rregullt apo kontribute pensionale të paguara në emër të tyre. BSPK-ja raportoi se punëdhënësit nuk i përfillnin dispozitat ligjore dhe i përjashtonin punëtorët pa arsye në kundërshtim me ligjin dhe refuzonin t'i respektonin festat e punëtorëve. Deri në nëntor, Inspektorati i Punës pranoi 433 ankesa zyrtare për shkelje të të drejtave të punëtorëve në sektorin publik dhe privat. Organizata për të drejta të gruas raportuan se abuzimi dhe ngacmimi seksual ndodhte në vend të punës, por kalonte pa u raportuar për shkak të frikës për përjashtim nga puna apo hakmarrja.

Ndonëse ligji parashikon mbrojtje të shëndetit të punëtorëve dhe kushte të punës, institucionet private dhe publike nganjëherë nuk e respektonin atë. Zyrtarët e Inspektoratit të Punës dhe të BSPK-së raportuan vështirësi në marrjen e informatave të sakta për zbatim pasi punëtorët rrallë i zbulonin problemet për shkak të frikës për humbje të vendit të punës. Deri në nëntor, Inspektorati i Punës raportoi për 8 fatalitete dhe 44 aksidente të rënda në vend të punës.

Asnjë ligj në veçanti nuk i lejon punëtorit ta lërë punën për shkak të një situate të rrezikshme të punës, por ligji kërkon që çdo punëdhënës t'u sigurojë kushte adekuate të punës të gjithë punëtorëve duke u bazuar në kërkesat e punës. Sipas Ministrisë së Punës, marrëveshjet jozyrtare punëdhënës-punëtor mund ta trajtojnë çështjen kur dhe nëse një punëtor mund ta lërë punën për shkak të situatave të rrezikshme të punës. Institucionet e vendit nuk i kanë shqyrtuar këto marrëveshje.